



# shqipëria Etnike



Fati ynë nuk është shkruar për ne, por është shkruar prej nesh!

**OBAMA**

E shtunë  
26 korrik 2014

Viti XIV  
nr 155

Cmimi  
30 L / 1 euro

E pavarur,  
periodike

www.shqiperia-etnike.com  
shqiperia\_etnike@yahoo.net

English, page 14

Drejtor  
Sokol Pepushaj



**ISLAMI DHE SHQIPTARËT**

Arben Çokaj  
faqe 4



**PRANGA "PE-SHKAQENËVE"**

Andrea Stefani  
faqe 6



**KUR SHIKON NË THELLËSI...**

Fadil Kraja  
faqe 13

## Amerika - shteti i lirisë...

Sokol Pepushaj  
faqe 2



## Vetës-hembja e Maqedonisë

Aleksandër Çipa  
faqe 11



## Sfida serioze e Rilindjes

Kadri Ujka  
faqe 11



# Autoriteti dhe pjekuria e deputetit Tom Doshi rritën shpejt kreditet e politikës shqiptare

faqe 2-3

## Kole Laka Durgaj patriot ne mes patrioteve

*U VRA NGA FORCAT PARTIZANE NE JANAR 1945 / faqe 15  
Nga Gjeto Turmalaj*



## Nostalgjia për Hoxhën

Ardian Ndreca  
faqe 12



## Diplomacia, risia e Ramës

Mustafa Nano  
faqe 7



## Ramiz Çoba për njerëzit

Qamil Gjyzezi  
faqe 5



# Autoriteti dhe pjekuria e deputetit Tom Doshi rritën shpejt kreditet e politikës shqiptare

Nga Sokol Pepushaj

Kishte 23 vjet që politika shqiptare ishte mosbesuese, madje shpeshherë në vazhdimësi përplasëse me ndërkombëtarët e veçmas me politikën e Shtëpisë së Bardhë. Oguri i mire lëshoi rreze pikërisht pas zgjedhjeve të 23 qershorit 2013. Fill pas nisjes së punës së qeverisë Rama, shteti i lirive dhe të drejtave njerëzore forcoi lidhjet me njërin ndër politikanët më të besuar e më serioz shqiptarë, deputetin Tom Doshi. Është pikërisht ky deputet që mbajti mbi vete, pa nerva paranojake, mjaft akuza të lëshuara nga partia demokratike, analoge këto edhe me akuzat që kjo parti lëshoi dendur mbi disa ambasadorë si Marisa Lino, Yohn Withers, Alexander Arvizu, apo edhe mbi gazetata prestigjioze "The Washington Post" e "The New York Times", të cilat ishin krahasuar banalisht me letra higjenike. Një çmenduri fjalori nuk mund të ndeshet as tek talebanët, por këtu në Shqipëri gjithë shqiptarët i kanë dëgjuar. Janë pikërisht ato gojë të liga që ishin mësuar të mbushin xhepat e vet me taksat e votuesve dhe që donin ti mbanin prapë skllever, që nuk e dinin se deputeti

Doshi ishte një mik, një i besuar, një person që amerikanët e kishin studiuar mirë dhe e dinin se pasuritë i kishte vënë në mënyrë të ligjshme, duke paguar taksat për çdo cent, madje edhe duke bërë bamirësi, pra që ka hyrë në politikë pikërisht siç hyjnë senatorët e kongresmenët, prandaj gjuanin me "gurë" deputetin si tek shkëmbi i Mekës. Edhe e gjuanin, edhe i shtrinin dorën si lypsarë. Deputeti Doshi duket se i fali, duke i lënë në madhështinë e të zëmëruarve me "gurë" nëpër duar dhe, sapo qeveria nisi punën, pikërisht nga data 5 deri më 13 nëntor të vitit të shkuar, ai vazhdoi misionin e vet me ftesë zyrtare në Shtëpinë e Bardhë, i ftuar nga Këshilli Amerikano-Izraelitë i Marëdhënies me Publikun (AIPAC). Me autoritet, me pjekuri politike, larg formateve lindore, u takua dhe lëshoi në tryezën e logjikës mendime që tashmë kanë marrë formë e jetë, me shumë personalitete si Z. Lee Losenberg - Kryetar i AIPAC, Z. Alan Solow - President i DLA Piper, Kryetar i Fushates Elektorale Obama-Biden 2012 dhe njeri prej miqve me te ngushte të Presidentit Amerikan Barack Obama, Z. Daniel Shure - President i Dhomes Amerikano-Izraelite

te Tregetise, Z. Steven A. Dishler - Drejtor i Fondit të Bashkuar Izraelit, Z. Leroy R. Allala - Drejtor Ekzekutiv i Chicago SCI, Z. Tom Bartkoski - Drejtor i Keshillit Nderkombetar te Biznesit ne Chicago etj.

Miqësia, besimi, autoriteti, pjekuria politike që ndoshta vlerësohet edhe me heshtjen e tij kur e goditnin me "gurë" si shkëmbin e Mekës, u shfaq në takim shume te perzemert që deputeti Doshi e realizoi me Kongresmenet Eliot Engel dhe Jim McDermott. Ky i fundit që Doshi nuk e përmendi asnjëherë as gjatë fushatës elektorale, kish përgatitur vizitën e deputetit në Shtëpinë e Bardhë disa muaj para zgjedhjeve.

Ky deputet ishte po ne Shtëpinë e Bardhë në fillim të marsit të këtij viti dhe vizita të tjera që nuk ka dashur ti publikoi, ka bërë prapë në Amerikë. Ne do na duhej shumë kohë të publikojmë gjithë ato projekte që e presin Shqipërinë pikërisht nga lidhjet e besimi i ndërsjellë, por po mjaftohemi duke nxjerrë vetëm majën e Ajzbergut, se mjaft biznese gjigande janë në politikën afatshkurtëta e afatgjatë të komunitetit të Biznesit Amerikano-Izraelitë që Shqipërisë do i çelin së pari rrugën

drejt lirive dhe ligjeve njerëzore e së dyti do rritin ndjeshëm ekonominë tone.

Deputeti Doshi duket se po mëndon edhe për zgjedhjet lokale të pranverës që vjen. Nga takimet tashme të shpeshta në Amerikë, Izrael dhe shume shtete të tjera, po lobon që Shkodrën që deri sot nuk ka ndezur në historinë e vet semafor, çka është për të qeshur me lot në cep të shamisë, ta binjakëzoi me bashkinë e Chicago-s. Madje ka rënë dakord me Kryetarin e Komisionit të Binjakëzimeve prane Bashkisë Chicago-s z. Leroy R. Allala që si nisje Doshi të akordoi bursa studimi për studentët e universitetit "Luigj Gurakuqi" të Shkodrës që të studiojnë në Universitetin e Chicago-s.

Puna e deputetit të Shkodrës Tom Doshi tashmë shihet dhe, sipas burimeve të sakta, në muajin tetor ai serish do ketë ftesë zyrtare ku do takohet e diskutoi probleme madhore për të ardhmen e Shqipërisë me miqtë e tij në Shtëpinë e Bardhë, pasi 23 vite të shkuara dëm të Shqipërisë, për të mos thënë edhe ecje pas, për deputetin Doshi duhen riparuar, pa shikuar mbrapa.

Ilustrimet ►

## Amerika, shteti i Lirisë dhe i të drejtave njerëzore

Ne, shqiptarët, duke qënë kombi më pro-amerikan në Botë dhe mbase të veçantë në ndërtimin e mardhënies, ku referuar popullsisë, padyshim jemi më i suksesshmi brënda kufijve të shtetit të lirisë, jemi borxhli ndaj respektit, ndaj njohjes sa më të thellë të historisë brilante deri në infinit të lirive dhe të drejtave njerëzore.

Më 1492, eksploruesi Gjonevez Kristofor Kolombi, i kontraktuar nga Kurora Spanjolle, mbërriti disa prej ishujve të Karaibeve, duke shënuar kontaktin e parë me popullsinë vëndase. Shteti i Lirisë dhe Demokracisë së kësaj toke, këtë 4 korrik festoi përvjetorin e 238 të pavarësisë. Është pikërisht 4 Korriku i vitit 1776, dita e bekuar, dita që Kongresi Kontinental miratoi Dokumentin e Pavarësisë, duke e shënuar si ditën zyrtare të Pavarësisë së SHBA-ve. Ajo ditë e bekuar erdhi pasi Britania kishte arritur të përçante kolonët kolonët amerikanë, ku tre në katër amerikanë ishin besnikë të vëndosur të Britanisë. Pra populli as që mund të mëndonte se do arrinte gjë përmes luftës. Po Amerika kishte kapacitete njerëzore, kishte elitë, kishte heronj të lirisë. Pas revoltave të hapura dhe luftës mes kolonive dhe trupave ushtarake britanike, delegatët e 13 kolonive të Amerikës u mblodhën në Filadelfia në takimin e Kongresit Kontinental.

Diskutime mbi taksat që vinte Britania edhe kur kolonitë amerikane nuk kishin përfaqësues në Perandori, abrogimi i çdo ligji kur nuk u pëlqente britanikëve, dështimet për marrëveshje, çuan Kongresin në vëndimin për përgatitjen e Deklaratës së Pavarësisë. Thomas Jefferson ishte në krye të Komitetit të Zgjedhur për shkrimin e dokumentit. Ndërsa ata, Anëtarët e Komitetit punonin, Kongresi

vazhdonte të debatonte ne lidhje me çeshtjen e pavarësisë. Dhe vjen dita historike, 4n korriku 1776, dita kur u votua Deklarata e Pavarësisë. Deklarata e Pavarësisë fajësonte qeverinë britanike për të gjitha padrejtësitë që u ishin bërë kolonive. Në të deklarohej se qeveritë kanë të drejtën të ekzistojnë, vetëm për të mbrojtur të drejtat e popullit të tyre. Në Deklaratë gjithashtu thuhej se populli ka të drejtën të ndryshoi qeverinë, nëse ajo u mohon atyre të drejtat. Ky dokument bazë i të drejtave njerëzore nuk u prek asnjëherë. Kështu, më 1773, Britania e Madhe e njohu pavarësinë e tyre dhe iu dha edhe tokat prapa tyre, deri tek lumi Misisipi (Mississippi).

Për shkak të Kushtetutës së Federatës, të nxjerrë në 17 shtator 1787, më 1789 Xhorxh Uashingtoni shpallet President i Shteteve



të Bashkuara Amerikane. Pra, amerikanët megjithëse shumë të rinj në tokën e vet, me një histori që jo vetëm nuk i ka përkëllë, por ka qënë e egër me ta, sot janë shteti më tolerant në Botë, më i drejtë në Botë, më potent në Botë. Një Zot që është sakrifikuar në emer të lirisë e demokracisë globale, çka Amerika

fizike të kujton Jezu Krishtin.

Amerika ka një sipërfaqe prej 9,83 milion km<sup>2</sup> dhe me popullsi prej mbi 308 . 745 . 538 banorë, sipas regjistrimit të popullsisë të filluar më 1 prill të vitit 2010 që njihet si dita zyrtare e regjistrimit. Formularë e regjistrimit u ndanë në 59 gjuhë të ndryshme.

Sipas studimit të fundit, 78,4 % e të rriturve identifikoheshin si të krishterë. Totali i religjioneve jo të krishtera raportuar është 4,7 %, Pra feja luan një rol shume te rendesishem, siç thotë dhe Kushtetuta Amerikane: Ne besojmë në Zot.

Amerika e Lirisë dhe që u ka hapur dyert e zemrat gjithë racave ka realizuar regjistrimin e 23-të të popullsisë, pasi Kushtetuta Amerikane ka vendosur një herë në 10 vjet regjistrim. I pari regjistrimi popullsisë në

sore e supershtetit. Vala e emigracionit e zhvilloi ekonominë amerikane me hapa galopantë Emigrimi dhe migrimi brëndapërbrenda, duke shtuar shpejt popullsinë dhe duke tërhequr mendjet e ndritura të botës, ndikuan në largimin e Indianëve nga tokat e tyre në lindje të Misisipit dhe shkatërrimin e vendbanimeve të tyre në perëndim të shtetit të Arkansasit dhe Misurit (Missouri). Në këto pjesë Indianët vende-vende kishin vendbanimet e tyre, vende të cilat sot janë si rezervate Indian Amerika sot ka rolin primar në gjithë yhvillimet globale.

Veçmas pas ngjarjeve të 11 shtator 2001, ku terroristët e al-Kaidës goditën Qendrën Botërore të Tregtisë në Nju Jork dhe Pentagonin në Washington D.C., duke vrrarë gati tremijë njerëz , qytetarë të Botës, qytetarë të amerikës, mes tyre edhe shqiptarë.

Demokrati Barack Obama, presidenti i 44-të amerikan , i pari afro-amerikan që mban këtë post, është shëmbulli më i mirë i materializimit të lirive dhe të drejtave që zoti i jep njeriut në tokë. Të gjithë presidentët e mëparshëm kanë qënë me prejardhje evropiane.

Kombi shqiptar, me një të kaluar të lavdishme, me prejardhje ilirike, ndër më të lashtët në europë, jo pa arsye ka gjetur mbështetjen më të fortë pikërisht nga Amerika. Shqiptarët sot, ambasadorin Amerikan në Tiranë Alexander Arvizu, e shohin si mbrojtës të të drejtave edhe më elementare.

Amerika na do shumë, por së pari ta duam sadopak veten.

Sokol Pepushaj



*Deputeti Doshi me Kongresmenin Eliot Engel*



*Në Shtëpinë e Bardhë*



*Me Z. Lee Rosenberg - Kryetar i Keshillit Amerikano-Izraelit te Mardhenieve Publike AIPAC, si lobi me i fuqishem politik dhe ekonomik ne ShBA.*



*Doshi me mikun e tij Alan Solow - President dhe Partner i DLA Piper, mik i ngushte i Presidentit Barack Obama, i cili i konfirmoi hapjen e zyes se tij ne Shqiperi brenda ketij viti*



*Me Kongresmenin e Shtetit te Washingtonit Jim McDermott*



*Me Z. Steven A. Deshler - Drejtor i Fondacionit te Bashkuar Hebre i cili mbledh dhe shperndan ne forme bamiresie miliarda Dollare çdo vit*



*Takim i deputetit Doshi me Presidentin e Dhomes Amerikano-Izraelite te Tregetisë, z. Daniel Shure.*



*Takim me Z. Tom Bartkoski - Drejtor i World Business Chicago*



*Takim shumë miqësor me Z. Leroy R. Allala - Kryetar i Komisionit te Binjakezimeve prane Bashkisë Chicago*

# Islami dhe shqiptarët

## Psikanalisti i famshëm Karl Jung e krahason Hitlerin me Muhamedin a.s.

Nga Arben Çokaj,  
Frankfurt am Main

**...FEJA DOMINON NË SHTETET E DOBËTA, PASI SI PJESË E PUSHTETIT MBI NJERIUN, FEJA DHE SHTETI JANË NË KONTRADIKTË. SHTETET E FORTA I TREGOJNË VENDIN FESË, KURSE SHTETET E DOBËTA, GJUNJËZOHEN PARA SAJ. PRANDAJ NË SHQIPËRI TERRORIZOHENI TË GJITHË NGA THIRRJA E ZANIT, SE SHTETI ËSHTË I PJERDHUR. LIGJET DEMOKRATIKE NUK E LEJOJNË PRISHJEN E QETËSISË PUBLIKE DHE SHKELJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT, SIÇ NDODH NGA FEJA TEK NE. PËRZIERJA E PUSHTETIT ME FENË SJELL MOS-ZHVILLIM SHOQËROR. DIKUR FEJA E KRISHTERË ISHTE SË BASHKÛ ME PUSHTETIN NË EVROPË DHE PËSUAM MESJETËN. KURSE TANI PROBLEMI MË I MADH VJEN NGA ISLAMI, PASI AI ECËN ME PSIKOLOGJINË SOCIALE TË SHEKULLIT TË 7-TË...**

Në një kohë të hershme, kur njohuritë e njeriut për tokën dhe universin ishin tepër të vogla dhe kur njeriu i lashtë habitej me dukuritë natyrore apo prejardhjen e vet, pyetja shpesh bëhej, nga e ka prejardhjen njeriu? Nga vjen, kush e krijoi? Dhe duke mos qenë i aftë njeriu i atëhershëm të gjente një përgjigje të agumentuar, ai gjeti mënyrën më të mire për të qenë i lumtur: gënjeu vetveten! Regjisori i njohur amerikan, Woody Alen, në një intervistë të tij të kohëve të fundit, ka gjetur formulën e lumturisë. Ai thotë se, “që të jesh i lumtur, duhet të gësh një gënjeshtër dhe të rrish duke mashtruar vetveten gjithë jetën!”

Duket se pikërisht këtu e ka zanafillën edhe feja. Një përpjekje e njeriut për të gënjer vetveten, në një kohë kur njeriu nuk ishte edhe aq i ditur. Por Zigmund Frojd sqaron se me rritjen e intelektit të njeriut, edhe feja apo besimi fetar, do të vijë duke rënë.

Moisiu e mori emrin nga grekët, kurse në original, ai quhej Moses, i biri, në gjuhën egjiptiane. Muhamedi a.s. ia arabizoi emrin atij në Musa. Hazerti Musaja a.s. (aleisalam), ashtu si për Jezusin, hazerti Isaja a.s. Pra, Moisiu mbahet si themelues i fesë monoteiste, ndonëse besimi në një Zot të vetëm lindi me Abrahamin. Për Moisiun thonë se ishte një fëmijë i vogël, i cili u gjet në një shportë zunkhi, të lyer me rrëshirë në lumin Nil dhe u shpëtua nga princesha e fareonit. Ai u rrit në familjen e fareonit, dhe periudha e kohës, kur u themelua edhe feja monoteiste nga Akenotek, zoti i diellit, ishte edhe koha kur besohej se zoti i tokës ishte dielli. Pas vdekjes së Akenotekut, pati rrëmujë në Egjipt, dhe Moisiu, një general i faraonit, i priu popullit hebre, i cili ishte popull skllav dhe u largua nga Egjipti. Dhe populli hebre, e pranoi Moisiun egjiptian si prijësin e vet, duke besuar edhe në fenë e tij, e cila u transformua nga feja e Akenotekut, prej besimit tek dielli, si zoti i tokës, tek besimi në një Zot të vetëm. Kjo është pak a shumë edhe prejardhja e feve monoteiste nga Moisiu.

Është interesant fakti se Moisiu ka një histori të lindjes së tij, identike me Sargon Akkadin – themeluesin e Babilonisë së lashtë, 2800 vjet para Krishtit. Sargon Akkadi tregon në shkrimet e gjetura mbi rrasa guri, se atë e hodhi e ëma e tij në lumin Euftrat, në një shportë zunkhi të lyer me rrëshirë... Duke u nisur nga kjo, studiuesve të fesë, që e marrin fenë si fenomen shoqëror e jo hyjnor, u shkollon

në mendje se këto histori janë manipulur në atë mënyrë, për të gjetur përkrahjen e njerëzve, për të depërtuar sa më lehtë në nën-ndërgjegjen e tyre, për të kapur masat, dhe në këtë mënyrë për t’u mitizuar, për t’u bërë mitike.



Frojd thotë: Feja është një neurozë obsesionale gjithënjëzore! Ndërsa Karl Jung vijon: “Fe do të thotë varësi nga irracionajla, nënshtrim i tij si realitet objektiv, e cila nuk përshtatet drejtpërdrejt me kushtet sociale dhe fizike, por që më shpejt përputhet me orientimet psiqike të individit.” Dmth. Hyn më lehtë në ndërgjegje. Feja është infantilizëm, irracionale dhe përfaqëson pavetëdijen e njeriut. E megjithatë, njerëzit e paditur vazhdojnë të besojnë.

Kafshët janë pavetëdije, ato jetojnë në vath me kashtë. Prandaj edhe hyu lindi në kashtë... si rrjedhojë për të ndikuar pavetëdijen e masës dhe për t’u bërë sa më i besueshëm për masat e paditura. Pse nuk lindi hyu në një tempull, apo pallat? - pyesin psikoanalistët Frojd e Jung! Konkretisht, po citoj Jungun: “Pavetëdija pranohej thjeshtë si natyrë e kafshës, nëse kjo nuk është një grumbullim i mosfunksionimit të ndërgjegjes... Njeriu masiv i pret emocionet e tij në grumbullimet masive... Fetarët orientohen nga këto dhe e pranojnë këtë çmenduri!” Jungu - djali i një pastori gjerman - mendon në vetvete, se feja ka një ndikim psiqik mbi njerëzimin, është një trashëgimi kulturore, sidoqoftë, ndikon mbi pavetëdijen e njerëzve, duke

krijuar një iluzion. Feja në vetvete hyn në ndërgjegje që fëmijë dhe i krijon individit dominancë, një shtet brenda kokës së tij – thotë Frojdi. Prandaj mendohet se është më mirë, që fenë ta marrin njerëzit kur të rriten, se në atë moshë kanë edhe mundësi

lemi më i madh vjen nga islami, pasi ai ecën me psikologjinë sociale të shekullit të 7-të. Nëse marrim parasysh faktin se Magna Carta – karta e parë e të drejtave të fisnikëve anglezë, u firmos nga mbreti anglez me 15 qershor 1215, merret me mend tani se sa të drejta ka patur njeriu në shekullin e 7-të, kur u shkrua Kur’ani. E përderisa Kur’ani që në atë kohë është i pandryshueshëm, dhe tenton edhe sot të bëhet model shoqëror, atëherë nuk ka dyshim që shoqëritë që ndjekin Kur’anin janë të destinuara të mbesin prapa. Shoqëritë islame i lënë edhe gratë pa punë, pa kontribut në të ardhurat publike. Dhe duke mbajtur mbi gjysmën e popullsisë pa kontribut në sektorin publik, shoqëria do të mbetet padyshim e prapambetur. Prandaj, mos u habitni shumë shqiptarë të nderuar, dhe sidomos ju që dashuron islam, se pse ne jemi kombi më i përçarë dhe më i prapambetur në Evropë. Ja ku e keni shkakun dhe përgjigjen.

Në një intervistë për një gazetar amerikan në vitin 1938, psikanalisti Karl Gustav Jung e krahason Hitlerin me Muhamedin a.s. nga pikëpamja e mitizimit të tyre për së gjalli. Jungu sqaron se diktatorë si Hitleri e kanë pavetëdijen e madhe dhe ata pasqyrojnë pavetëdijen e popullit të tyre, prandaj pavetëdija e tyre godet si megafon mbi pavetëdijen e çdo gjermani, ashtu siç synon të godasë feja islame me altoparantet e eZanit të lartë mbi pavetëdijen e çdo myslimani. Duke shfrytëzuar shtetin e dobët e të pavetëdijshëm shqiptar, xhamitë shqiptare po lulëzojnë përditë, dhe përderisa nuk i ndalon askush, ato po bërtasin me ahengun arab, duke dhunuar edhe tolerancën fetare dhe respektin, që shqiptarët tregojnë për besimin e njëri-tjetrit. Pyetja është, po shkojmë drejt një shteti demokratik, apo islamik?

Nëse shoqëria shqiptare shkreteton në fe, ajo bëhet irracionale, humbet sensin e realitetit dhe merr tiparet e një vendi të pazhvilluar dhe problematik, ashtu siç ka qenë dhe është edhe sot. Shqipëria duhet të lëvizë drejt një shteti ligjor dhe të së drejtës dhe drejt zhvillimit ekonomik, krijimit të firmave të suksesshme shqiptare, investimeve private dhe hapjes së vendeve të punës. Vetëm kështu, ekonomia jonë mund të bëhet e shëndetshme dhe mund të shërohet e konkurrojë tregun. Dhe vendi e kombi ynë, mund të ecë përpara! Me punë!

të zgjedhin...

Një nga fenomenet më kontradiktore të trajtesës psikologjike e psiko-analitike të fesë nga Frojd & Jung është edhe fenomeni i “vrasjes së t’atit”, i cili si duket u theksua më shumë me Niçen (Nietzsche). Vrasja e të atit, dmth. psikologjikisht, vrasja e autoritetit të babait – çuditërisht, i kemi të gjithë ashtu, Moisiun pa baba, Jezusin gjithashtu, por edhe Muhamedin a.s. jetim. Në Evropë, kjo ka ndodhur nga pikëpamja shtet-formuese, pasi ligji qëndrom mbi të gjithë dhe asnjë individ nuk ka autoritet dominant mbi shoqërinë, përveç ligjit. Kjo ka sjellë zhvillimin e shoqërisë. Ndërsa feja dominon në shtetet e dobëta, pasi si pjesë e pushtetit mbi njeriun, feja dhe shteti janë në kontradiktë. Shtetet e forta i tregojnë vendin fesë, kurse shtetet e dobëta, gjunjëzohen para saj. Prandaj në Shqipëri terrorizohemi të gjithë nga thirrja e Zanit, se shteti është i pjerdhur. Ligjet demokratike nuk e lejojnë prishjen e qetësisë publike dhe shkeljen e të drejtave të njeriut, siç ndodh nga feja tek ne.

Përzjerja e pushtetit me fenë sjell moszhvillim shoqëror. Dikur feja e krishterë ishte së bashku me pushtetin në Evropë dhe pësuam Mesjetën. Kurse tani prob-

# Ramiz Çobaj për njerëzit dhe në shërbim të tyre

Nga **Qamil Gjyzezi**

Nga Qamil Gjyzezi Politika për njerëzit dhe në shërbim të njerëzve duhet të jetë edhe motivi i cdo partie politike në Shqipëri, që kërkon integrimin në Europën demokratike dhe të përparuar. Nëse njerëzit nuk do të jenë në qendër të politikave të partive tona edhe integrimi politik dhe kulturorë në Europë do të jetë i largët. Të gjitha partitë politike në vendet demokratike europiane pas luftës së dytë botërore, vunë në epiqendër njeriun pa asnjë dallim. Votimet në P.D.-në e Shkodrës ishin demokratike, të lira ku secili anëtarë votoi kandidatin për kryetarë partie dhe institucionet drejtuese të kësaj force politike në metropolin e veriut që ka nevojë të krijojë një frymëmarrje të re në të gjitha planet, atë politik, ekonomik, social, psikologjik dhe mbi të gjitha në planin njerëzorë. Në balotazh anëtarët e P.D.-së i besuan Ramiz Cobaj drejtimin e kësaj force politike në vitet e ardhshme. P.D. në Shkodër ka shumë anëtarë të niveleve dhe fushave të ndryshme, të cilët do ti prezantojnë elektoratit të djathtë liberal ide dhe projekte shumë shpresëdhënëse për të ardhmen e Shkodrës dhe qarkut të saj. Kam besimin e plotë se P.D. do të rishikojë shumë politika të funksionimit të saj, të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe natyrore dhe mbi të gjitha historisë që përfaqëson ky qytet dhe qarku i Shkodrës me plot mundësi për të jetuar, kulturë dhe dashamirësi. Ramiz Cobaj ka përpara një sfidë që sëbashku me të gjithë demokratët e Shkodrës dhe institucionet drejtuese të kësaj partie do ta realizojë, bashkimin, ringritjen dhe hapjen e P.D.-së, mbi të gjitha me njerëz vizionarë, jo

me cinizëm dhe mungesë alterantive dhe politikë klienteliste. Shkodra ka shumë njerëz vizionarë në të gjithë qarkun. Prandaj politika e re e Cobaj dhe P.D.-së, duhet të vejë në epiqendër njeriun. Partitë liberal demokrate moderne venë njeriun në epiqendër, njeriun që kërkon ekonomi, zhvillim dhe një të ardhme të mirë në një rajon dhe një botë e cila ka plot probleme ekonomike të cilat po shkojnë drejt stabilizimit. Ky është edhe misioni i të gjithë partive popullore në Europë.



Kjo është një strategji e re që ndjek mbi të gjitha C.D.U. gjermane dhe partitë e tjera popullore europiane dhe në botë, cdo gjë për njerëzit. Me të vërtetë politika ka në thelbin e saj zhvillimin ekonomik, shoqërorë, kulturorë dhe zhvillues, por e gjithë kjo politikë bëhet mbi të gjitha duke forcuar njerëzit, komunitetet ku partia drejton, qeverisjet lokale dhe rajonale. Njeriu është në epiqendër të cdo projekti

europian. Në botën post-moderne politika po i ofrohet gjithnjë e më tepër njerëzve të cilëve ju merr vota. Elektorartet janë bërë inteligjentë. Ramizi është person tipik i afrueshëm, fisnik, fjalëpak dhe njeri me vizion dhe menaxher politikë i aftë. Ramizi ka një përgjegjësi tjetër të madhe. Ramizi e mori P.D.-në humbëse. Është hera e parë në historinë e P.D.-së në Shkodër që humb në këto 23 vjet. Krahas një seri faktorësh P.D. humbi pasi humbi lidhjet me elektoratin e saj por mbi të

të kësaj pjese të rëndësishme të gjithë Shqiptarëve. Natyrisht duhet të ringjallen edhe burimet njerëzore të qytetit, që shpesh janë keqpërdorur ose amortizuar, kryesisht rinia e shkolluar brënda dhe jashtë vendit. Njerëzit kanë probleme materiale dhe shoqërore, por ato kanë edhe probleme psikologjike. Një kryetarë i një force liberal demokrate sic është P.D., duhet të ringjalli mbi të gjitha shpresën e humbur tek njerëzit. Ramizi duhet të vazhdojë projektet politike për bashkimin, ringritjen dhe hapjen e P.D.-së në të gjithë qarkun, një proces që kërkon projekte të vecantava dhe intensive. Duke e mblyllur këtë analizë të shkurtër modeste po citoj Ramiz Cobajn në një debat të para dy ditëve me një "pseudopolitikan" shkodoran, nga një forcë pa emër sic e përshkruan Ramizi vetë nga statusi i tij në F.B. Lexuesi shpresoj do të kuptojë qartë edhe idetë dhe projektet politike të Ramiz Cobaj: "Mjerimi politik është në garë me mjerimin moral dhe atë ekonomik. Këto ditë mjerimi politik po ua kalon atyre. Kjo vertetohet nga deklarata jo qytetare në emër të qytetarisë e një gjoja politikani që flet në emër të një force politike që shkodoranet nuk ia dinë as emrin, por e identifikojnë me emrin e një personi, thjesht për shkak se nuk është bërë akoma parti dhe ka pak gjasa të bëhet. Sigurisht, partia bëhet

me njerëz vizionarë dhe jo racistë." Nga kjo deklaratë e zotit Cobaj del qartë edhe vizioni i tij politik, shumë demokratik, qytetarë dhe me synim njerëzit dhe shërbimin karshi njerëzve dhe vlerësimin e tyre. Vetëm projektet njerëzore politike do të krijojnë një imazh tjetër për Shqipërinë dhe shqiptarët në Europë dhe botë.

gjitha me njerëzit e përditshëm Është e pafalshme për një forcë liberal-demokrate nëse nuk ju afrohet njerëzve. Në misionin e tij Ramizi duhet të identifikojë burimet njerëzore të Shkodrës dhe qarkut të Shkodrës. Shkodra krahas burimeve natyrore, ka edhe burime njerëzore të pafundme. Shkodra ka potenciale njerëzore shumë kreative. Shkodra ka malësinë që përfaqëson mitikën, fuqinë vertikale

## Hasmëri që nga nga viti 1997, po me kë?!

Gjatë vitit 1997, kur në Shqipëri u shpërthyen depot e armatimit të ushtrisë dhe u grabitën nga populli thujse gjithë armët e zjarrit si rrjedhojë e shëmbjes së piramidave, ku shqiptarët humbën gjithë pasuritë e tyre, u vranë rreth 4.000 shqiptarë. Konfliktet e atij viti vazhdojnë të marrin jetë të pafajshme edhe sot dhe statistikat flasin për 20.000 shqiptarë të vranë në 20 vitet e fundit dhe për një numër të madh që asnjëherë nuk dihet saktësisht të



familjeve të ngujuara dhe qindra fëmijëve që nuk shkojnë në shkollë nga frika se një hasëm i pushkaton. Madje vetë ministria e arsimit Lindita Nikolla, ka shkuar kohët e fundit në një shtëpi të ngjuarish në fshatin Bleran të komunës Rrethina të qytetit verior Shkodër dhe u ka dhënë një orë mësimi në kushte ngujimi, disa fëmijëve që nuk mund të kalojnë muret e shtëpisë nga frika e vrasjes. Edhe viktimat e pafajshme që po trajtojmë në këtë

shkrim është pikërisht nga fshati Bleran i komunës Rrethina në Shkodër. Quhet Edmond Logaj, bashkëshorti i mirë dhe baba i katër fëmijëve, tre vajzave dhe një djali. Ky njeri ka 17 vjet i ngjuar dhe shumë herë është kërcënuar me jetë dhe paradoksi qëndron në faktin se as ai vetë nuk e di se pse. Madje, një herë që ka qënë duke udhëtuar me motor, rast që ka dalë për të blerë ca ushqime për fëmijët, edhe pse është ruajtur nga ndonjë sulm, një makinë ka arritur ta përplasë, duke i shkaktuar edhe plagë në trup, por që fatmirësisht jo me rrezik për jetën. Ngjarja dhe kërcënimet e shpeshta kanë lidhje me datën 24 qershor 1997, ditë kur kushëri i tij, më saktë djali i xhaxhait, i quajtur Kolec Logaj, po shkarkonte një karrocë zhavor në lagjen 'Skenderbeg' të qytetit Shkodër dhe një person i panjohur që shkon me makinë aty i thote se më ke bllokuar rrugën. Kolec Logaj i përgjigjet se ka edhe dy lopata zhavor për të shkarkuar dhe po

ia lëshon atë rrugë që vërtet është e ngushtë. Personi i panjohur nuk ka pritur asnjë sekond por ka nxjerrë pistoletën dhe e ka qëlluar me një plumb në ballë. Viktima ka vdekur në vend. Familja Logaj nuk ka bërë denoncim në polici, pasi nuk dihej autori dhe nuk besonte tek policia, e cila në shumë raste bashkëpunon me kriminellet. Nuk kanë kaluar shumë ditë dhe po në lagjen 'Skenderbeg' të Shkodrës, një person i panjohur, pikërisht ai vrasësi, ndalon në rrugë të quajturin Edmond Logaj dhe i thote se 'edhe ty do të vras, ashtu siç kam vranë kushëririn tënd'. Që aso kohe Edmond Logaj jeton i fshehur dhe familjen e mban gruaja e tij që rropatet duke punuar punë nga më të rëndomtat dhe duke u ruajtur, kushedi nga kush, që te mos vritet, pasi për të shoqin as bëhet fjalë të dalë jashtë. Ditët e fundit arritëm ta kontaktojmë këtë person që shprehet se edhe ai nuk e di pse e kërcënojnë me jetë dhe kush është personi. **Redaksia**

# Pranga “peshkaqenëve” ose korrupsioni një ritallje me shqiptarët!

Nga Andrea Stefani

U bënë 300 ditë të qeverisë së Kryeministrit Rama, por përballja me korrupsionin ka qenë aq e vakët sa vështirë të meritojë emrin “luftë”. Shqipëria vazhdon të jetë një shtet ku pasurimi korruptiv i një shtrese ish-qeveritarësh perceptohet me sy të lirë, por askush nuk vepron për ta ndëshkuar këtë korrupsion. Kjo është specifika e Shqipërisë sot. Dhe ndërsa statusi i pandëshkueshmërisë i disa politikanëve, zyrtarëve apo gjyqtarëve të pasuruar llahtarisht mbetet po aq i paprekshëm sa më parë, shpresa dhe besimi për një antikorrupsion të vërtetë, që do t'i rreshtonte të gjithë barabar para ligjit, po tretet me shpejtësi. Lajmet për hetimin e ndonjë mjeku, mësuesi apo infermieri për marrje ryshfeti, ngjallin vetëm qesëndi. Në fakt, tingëllojnë si një maskim me antikorrupsion të vogël paaftësinë për të luftuar korrupsionin e madh. Dhe askush nuk do të besojë të prokuroria dhe drejtësia dhe vullneti politik i qeverisë “Rama” për antikorrupsion, nëse në rrjetin e drejtësisë bien vetëm ca cironka të vogla ryshfetesh dhe jo peshkaqenët e korrupsionit 23-vjeçar që kanë gëlltur miliona nga buxheti i shtetit më të varfër të Europës.

\*\*\*

Peshku qelbet nga koka – është një thënie e vjetër. Edhe peshku i shtetit shqiptar është korruptuar nga koka, përpara se kalbëzimi të arrijnë te bishti. Dhe kokat janë presidentët, kryeministrat, ministrat e këtyre viteve që kanë bërë politika, kanë marrë vendime, kanë organizuar tenderë për punime dhe investime publike që më së shumti janë grabitur. Nuk është rastësi që dallgët e antikorrupsionit, në vendë kur ekziston vullneti politik, si dhe sistemi i institucioneve për t'i ngritur këto dallgë përlajnë, para së gjithash, presidentë dhe ish-presidentë shtetesh, kryeministra dhe ish-kryeministra si Kohl në Gjermani, Sanader në Kroaci, Berlusconi në Itali. Atje fryma e ligjit dhe e barazisë para tij nuk lejon që të marrësh në hetuesi Zhan Valzhanin se ka vjedhur një copë bukë dhe të lësh pa hetuar e gjykuar politikanin, kryeministrin apo ministrin që vjedh miliona nga buxheti publik. Atje antikorrupsioni nuk hedh vetëm grepin për të kapur cironka, por edhe rrjetin e hekurt për të kapur peshkaqenët e korrupsionit.

\*\*\*

Por, në Shqipëri, vazhdon të jetë ndryshe. Në Shqipëri vazhdon të triumfojë kulti i të plotfuqishmit që nuk pyet për ligj. Kush ka qenë në pushtet dhe ka vjedhur miliona i bëfshin mirë. Drejtësia nuk ka punë me ta. Vite më parë kur që në opozitë, Sali Berisha sokëllinte kundër

për ta bërë luftën antikorrupsion një funksion organik të shtetit, pavarësisht axhendave apo vullnetit politik të qeverive dhe që vijjnë e shkojnë. Berisha, me forma nga më të ndryshmet (nga korrupsioni e deri te presioni i hapur), bëri zap institucionin e prokurorisë dhe gjykatat. Rrallë do të gjendet në historinë e

kaq gjatë në pushtet dhe në politikë nëse nuk asgjësonte ato institucione hetimi dhe drejtësie që nuk njohin të gjithëpushtetshëm, por vetëm shtetasin që, kur shkel ligjin, përgjigjet para tij si edhe çdo qytetar tjetër. Madje kur shtetasi që ka shkelur ligjin duke bërë korrupsion është zyrtar i lartë, ministër apo

\*\*\*

Sa që në pushtet, Berisha i obstruktioi hetimet ndaj korrupsionit të familjes dhe klanit të tij me kapje të prokurorëve dhe gjykatësve dhe aty ku kjo nuk funksionoi, me presione të hapura dhe brutale. Por ajo që nuk u bë në kohën e Berishës duhet të bëhet sot, kur ai nuk është më në pushtet. Është e vërtetë që qeveria “Rama” ndesh një pengesë të madhe që është, mungesa e një sistemi të pavarur drejtësie. Por ajo duhet të bëjë pa vonesë atë që i takon asaj. Të ridenoncojë në prokurori të gjithë dosjet e korrupsioneve, superskandaleve dhe krimeve (Rruga Durrës-Kukës, Gërdeci, 21 janari, Porto Romano etj.) të harruara apo pezulluara me “procedura ligjore” nga shërbëtorët e qeverisë së mëparshme në prokurori e gjykata. Dhe në rast se prokuroria nuk bën detyrën që i ka ngarkuar Kushtetuta për të hetuar dhe për të dërguar në bankën e kauzës korrupsionin dhe krimin, për të cilën edhe paguhet nga publiku, atëherë shumica e sotme ka të gjithë të drejtën të largojë të gjithë ata prokurorë që nuk bëjnë detyrën. Duke filluar edhe nga kryeprokurori Llalla. Dhe kështu duhet të ndodhë me të gjithë ata që institucionet e shtetit i kanë kthyer në bastione të një ish-qeverie të korruptuar. Pra kundër shtetit.

\*\*\*

Koha nuk pret. Ose shumica dhe qeveria do të veprojnë me vendosmëri për vënien në funksionim të mekanizmit të drejtësisë që ndëshkon korrupsionin pa dallim (majtas, djathtas, lart e poshtë madje edhe në qendër po dëshet) ose do të vijë momenti kur zhgënjimi do të jetë i pashmangshëm dhe antikorrupsioni i Rilindjes do të rezultojë një ritallje. Sepse Rilindja ka premtuar antikorrupsion. Se pa antikorrupsion nuk mund të ketë Rilindje të shtetit. Se mungesa e vullnetit për të luftuar korrupsionin e djeshëm nuk mund të ketë shkak tjetër veç korrupsionit të sotëm apo aspiratës për korrupsion. Është në instinktin e njerëzve të pakorrupuar ta neverisin dhe urrejnjë korrupsionin, prandaj edhe ta luftojë. Qeveritarët e sotëm duhet të dëshmojnë me fakte se nuk u mungon ky instinkt. Vetëm korruptimi të pengon të luftosh korrupsionin. Qeveria “Rama” nuk ka rrugëdalje, ose do të luftojë korrupsionin ose do të damkoset edhe ajo me korrupsion! Rugë të mesme nuk ka!



korrupsionit “të padrinës së drogës Fatos Nano”. Dhe betohej se me të ardhur në pushtet do ta çrrënjoste korrupsionin e socialistëve dhe në vend do të triumfonte drejtësia. Por sapo erdhi në pushtet, ky sharlatan i radhës, nuk bëri gjë tjetër veçse u kujdes për pasurimin e familjes dhe klanit të tij politik. Majekrahët e Berishës kundër “mamuthëve të korrupsionit socialist” ranë në surdinë dhe pas 8 vjetësh qeverisje me “duar të pastra”, Shqipëria u gjend edhe më e kalbur nga korrupsioni dhe allishverishet. “Antikorrupsioni” i Berishës rezultoi një tallje me shqiptarët dhe një gjethe fiku për hallatet e një korrupsioni edhe më galopant.

\*\*\*  
Por Berisha i shkaktioi edhe një dëm tjetër të pallogaritshëm shqiptarëve, duke shkatërruar të gjithë sistemin që është i domosdoshëm

Shqipërisë një qeveri si ajo e Sali Berishës që është përfshirë në superskandale dramatike si investimi i Rrugës Durrës-Kukës, Gërdeci apo edhe krime si 21 janari dhe askush nga qeveria të mos jetë prekur edhe një qime floku nga drejtësia. Kjo nuk është një rastësi, por rrjedhojë e kapjes së sistemit të drejtësisë nga ish-qeveria “Berisha”, të kapjes së atyre institucioneve dhe atyre njerëzve që edhe sot i telekomandon si robotë, ndërsa qahet se qeveria “Rama” po sulmon institucionet e “pavarura”. Edhe ndër shtetit më të korruptuara edhe pa asnjë qeveritar të lartë nën pranga?! Po ku ka nxitje më të madhe për korrupsion edhe më të madh se ky mjedis pandëshkueshmërie dhe kalbëzimi të “drejtësisë”?

\*\*\*

Berisha nuk mund të mbijetonte

kryeministër, e dënojnë edhe më ashpërsisht, sepse përveç shkëljes së ligjit, ka edhe një faj tjetër, ka shpërdoruar besimin publik. Po të ekzistonin këta prokurorë dhe gjykatës në Shqipëri, dikush do ta kish thirrur në hetuesi shtetasin Berisha për të dhënë shpjegime se si “rastisi” që hektarët e tokës së blerë nga vajza e tij në Porto Romano për llogari të Damir Fazllic u përfshinë me një vendim qeverie si pjesë e një projekti për park energjetik, gjë që ia shumëfishoi vlerën duke i falur fitime të majme vajzës dhe mikut të tij të përfolur si mafioz? Rastësisht apo jo rastësisht, këtu kemi një konflikt të pastër interesi në një vendimmarrje qeverie, që asnjë organ i pavarur hetimi nuk mund ta neglizhonte. Për të mos folur pastaj për origjinën e milionave të përfshira në këto transaksione që janë një tjetër mesele që bie erë pastrimi parash.

## Nuk ndalon Dinamiti

**KJO NGJARJE U PARALAJMËRUA NË NJË BOTIM SPECIAL NË PORTALIN MË TË MADH TË LAJMEVE SHQIPTARE “LAJMI FUNDIT” NËN TITULLIN “EKSPLOZIV PRANË BANESËS NË SHKODËR” S’KA DEME NË NJERËZ”.**

Ngjarja ka ndodhur në periferi të shkoderës në fshatin Golem dhe pikërisht në banesën e shtetasit Rifat Kullaj, ku perona të panjohur kanë vëndosur një sasi dinamiti. Më datën 13.07.2014, rreth orës 01.00 është dëgjuar eksploziv që ka shpërthyer dhe menjëherë në vëndngjarje kanë shkuar forca të shumta policie dhe nga verifikimet është konstatuar se ka patur dëme material, por jo në njerëz (sepse qiraxhiu ishte larguar prej 10 ditësh). Burime të sigurta nga policia deklarojnë se kemi të bëjmë me një hakmarrje familjare. Sipas të dhënave që ka redaksia jonë, zoti Rifat Kullaj ka më shumë se një vit që është larguar nga Shqipëria dhe atij i janë sekuestruar të gjitha pronat nga pjestarë të afërm të familjes së tij. Policia, sidomos pas botimit në portalin më të madh shqiptar të informacionit nën titullin “Eksploziv pranë banesës në Shkodër, s’ka deme në njerëz” po punon për zbardhen e akteve terroriste, ku janë marrë në pyetje shumë persona, të afërm të familjes Kullaj, por deri tani nuk ka asnjë emer që akuzohet penalisht.

Redaksia

**LAJMI fundit**  
LAJMI FUNDIT: shtet me armë, e detyruan t'ua dorëzonte makinën - Saturday, July 19, 2014 - Barcelona, Bayerni

Ndani momentet e veçanta, në rrjetin më të mirë!

**Eksploziv pranë banesës në Shkodër, s'ka deme në njerëz**

Ngjarja ka ndodhur në periferi të shkoderës në fshatin Golem dhe pikërisht në banesën e shtetasit Rifat Kullaj, ku perona të panjohur kanë vëndosur një sasi dinamiti. Më datën 13.07.2014, rreth orës 01.00 është dëgjuar eksploziv që ka shpërthyer dhe menjëherë në vëndngjarje kanë shkuar forca të shumta policie dhe nga verifikimet është konstatuar se ka patur dëme material, por jo në njerëz (sepse qiraxhiu ishte larguar prej 10 ditësh). Burime të sigurta nga policia deklarojnë se kemi të bëjmë me një hakmarrje familjare. Sipas të dhënave që ka redaksia jonë, zoti Rifat Kullaj ka më shumë se një vit që është larguar nga Shqipëria dhe atij i janë sekuestruar të gjitha pronat nga pjestarë të afërm të familjes së tij. Policia, sidomos pas botimit në portalin më të madh shqiptar të informacionit nën titullin “Eksploziv pranë banesës në Shkodër, s'ka deme në njerëz” po punon për zbardhen e akteve terroriste, ku janë marrë në pyetje shumë persona, të afërm të familjes Kullaj, por deri tani nuk ka asnjë emer që akuzohet penalisht.

Redaksia

# Diplomacia, risia e Ramës dhe hapi i madh që duhet bërë më tej

**Nga Mustafa Nano**

Në periudhën 1995-1997 kam punuar në Ministrinë e Jashtme dhe duke filluar nga fundi i vitit 1996 e gjatë pothuaj të gjithë vitit 1997, pikërisht kur në Shqipëri mbretëronte anarkia e njohur, i kam shërbyer vendit në Zagreb. "I shërbej vendit" është një mënyrë e zakonshme formulimi për të gjithë ata që duan të thonë se punojnë në diplomaci. Kjo mënyrë të thëni është më me kuptim për ushtarët, por përdoret edhe në diplomaci, dhe afërmendsh, ata që e kanë përdorur më së pari në këtë rastin e dytë kanë dashur të përcjellin mesazhin, që diplomacia është një sektor i administratës publike që nuk ka kuptim të ketë lidhje me pushtetin e radhës. Sigurisht, ky i fundit mund të qëllojë që të ketë planifikuar, apo premtuar gjatë fushatës elektorale, të bëjë një diplomaci të ndryshme nga pushteti paraardhës, por këtë gjë do ta duhet ta bëjë me të njëjtët njerëz, me ata që kanë për një detyrim deontologjik "to serve their own country" (t'u shërbejnë pushtetarëve të momentit).

Unë isha zgjedhur të bëja diplomatin ato vite, edhe sepse kisha dëshirë (në fakt, më shumë kureshtje se sa dëshirë, e prandaj nga fundi i vitit 1997 e braktisa këtë profesion, që nuk e ndieja timin), por edhe sepse kështu donte Partia Demokratike në pushtet, e mbi të gjitha sepse kështu donte njeriu që e sundoi ("sundoi" në kuptimin germë për germë të fjalës) Shqipërinë në 1992-1997, Sali Berisha. Madje, ky ka qenë njeriu që ma ofroi këtë "mundësi". Ma ofroi në momentin që unë, si anëtar i Këshillit Kombëtar të PD-së, kisha dhënë shenja të qarta se

atë vetë e shihja si një rrezik të madh për vendin. Ai ma ofroi, dhe unë e pranova.

Merret vesh se kjo praktikë rekrutimi nuk ishte normale. Ishte në një masë të madhe e justifikueshme që diplomatët të ndërroheshin pas përmbyesjes së madhe, e në këtë kuptim, problem nuk ishte që u hoqën diplomatët e Enver Hoxhës, ndonëse edhe këta nuk kishin motiv pse

gjë e shpifur të punoje nëpër ambasadë edhe për një shkak tjetër. Ambasadorët, diplomatët e tjerë, e sidomos ata që nëpër ambasadë kishin ardhur nga radhët e SHIK-ut, mezi ç'prisnin rast për t'u shprehur kundër opozitës. Për të pritur a begenisur ndonjërin syresh as që bëhej fjalë. Opozitarët ishin armiq të, e ata nuk mund të priteshin. Ata duheshin lënë mënjatë, shpërfillur, denon-

sotme. Para tre-katër vitesh, një diplomat shqiptar në Washington u çua si me lezet nga tryeza e një Starbucks-i, me të dëgjuar se dikush që ish ulur me të tha se po priste aty ... Mustafa Nano. Kam mbetur pa gojë kur më thanë se "aty ish dhe filani, por kish ikur prej meje". Një diplomat që ka frikë që të takohet me një gazetar, që është kritik me kryeministrin!!! E pabesueshme,

meriton të përshëndetet, është një thyerje e fortë me një traditë të shëmtuar.

Të kuptohemi, nuk është se Rama po bën ndonjë gjë kushedi se çfarë. Kjo është një sjellje e praktikë normale, tepër normale, por që merr rëndësi pikërisht për shkak të një tradite mbi njëzetvjeçare tepër anormale. Dhe Rama, siç ndodh gjithnjë pas periudhash anormale, ka avantazhin që në disa drejtime të ketë sukses apo të bjerë në sy për mirë thjesht e vetëm duke bërë ca gjëra normale.

Vetëm se këto gjëra normale nuk janë mjaft. Në këtë kuptim, edhe në lëmin e diplomacisë, nuk është se kjo e fundit bëhet më efiçente e më e zonja nga momenti që do të hapë dyert edhe për shefin e opozitës e për të gjithë opozitarët. Jo, duhen ndërhyrje të një natyre tjetër për ta bërë diplomacinë më efiçente e më dinjitoze, siç janë rritja e rrogave të diplomatëve, ndalimi i praktikave të emërimeve nepotike, veshja e ambasadorit me pushtet të plotë admin-



të largoheshin *en bloc*. Problem ishte nëse, në vend të tyre, do të vinin njerëz me të njëjtin frymëzim politik e me të njëjtin disponim për t'i shërbyer, jo vendit, por partisë. Dhe ish pikërisht kjo që ndodhi. Rekrutimet në diplomaci u bënë tërësisht me logjikë politike, gjë që vetvetiu sillte që diplomatët t'i ndiheshin me hir, me pahir në borxh partisë, e sidomos "udhëheqësit". Përfaqësitë tona diplomatike u mbushën si në kohët e Enver Hoxhës, me besnikë të partisë, madje edhe më keq se sa kaq, u mbushën me njerëz fanatikë, që më shumë ngjanin me paramilitarë se sa me diplomatë. Ishte një

cuar, sabotuar. Kjo ka qenë diplomacia në atë kohë. Unë nuk di që të ketë pasur raste, që një opozitar i deklaruar të trokiste pa asnjë problem në një derë ambasadë e dera t'i hapej normalisht. Ka ndodhur me Besnik Mustafajn që ka pritur ndonjë opozitar në ambasadën tonë në Paris, por këta opozitarë ishin më së pari miq të ambasadorit. E pastaj, po flasim për Besnik Mustafajn, që si mik i ngushtë i Berishës kish një liri veprimi pak më të madhe se të tjerët. Dhe kjo frymë, ndonëse me kalimin e kohës në diplomaci është krijuar e respektuar një bërthamë profesionistësh, ka vijuar deri në ditët e

apo jo? Dhe për atë diplomat më thanë fjalë të mira, më thanë se ish një zotni burrë. Puna ishte se qyqari punonte në një klimë frike e survejimi. Donte të ruante vendin e punës, dhe takimi me një gazetar "armik" ish një arsye që ta humbte atë vend pune.

Sa më sipër i thashë, ngaqë dëgjova premtimin e Ramës se tash e tutje "opozita nuk do të luftohet më nga diplomacia, se përkundrazi ambasadat tona do të kenë edhe një protokoll pritjeje për shefin e opozitës, se ky protokoll pritjeje do të jetë i njëjtë me atë, që rezervohet për kryeministrin", etj., etj. E duhet thënë se kjo gjë është një risi që

istrativ (ka ende sot shoferë e shifrantë ambasadash që, ngaqë janë kushërinj të njerëzve me pushtet të Tiranës, kanë fuqi më shumë se vetë ambasadori), etj., etj. Koha e atyre "injorantëve, parazitëve, kushërinjve, hajvanëve", për të cilët flet Rama, nuk merr fund me fjalime. Koha e tyre merr fund duke ndërtuar një sistem të promovimit të njerëzve në diplomaci mbi kritere aftësishe e mbi bazë karriere. Dhe ky sistem ende nuk është ndërtuar. E nuk duket se ka ndonjë plan për ta ndërtuar. Ka shumë struktura brenda kësaj mazhorance që nuk janë të interesuara të ndërtohet një sistem i tillë.

## Breshëri plumbash në bjeshkë

**KJO NGJARJE U BË OBJEKT I NJË LAJMI TË KRONIKËS SË ZEZË NË TELEVISIONIN "TV 1 CHANNEL" TË QYTETIT VERIOR SHKODËR.**

Ngjarja e rëndë ka ndodhur me datën 8. 05 2014 në bjeshkët e Ura e Shtrenjtë, ku shtetasi Halil Xuferaj i datëlindjes 1946 ka dalë të kullojë bagëtitë në zonën Ndermalles dhe rreth orës 14.00 ai ka hyrë në pronën e shtetasit Brahim Myrto për të marrë ujë të pijshëm. Është diktuar nga i zoti i pronës Brahimi dhe janë konfliktua me fjalë fyese mes njëri-tjetrit. Në mes të grindjes ka ndërhyrë gruaja e Brahimit, e quajtuara Vera Myrto dhe për momentin ajo ka arritur ta qetësoi situatën. Është ky një veprim që njihet edhe

nga Kanuni i feodalit lekë Dukagjini, ku gratë kanë autoritetin të shuajne konflikte momentale. Nëse nuk ndodh kështu, burri që nuk respekton femrën koritet. Por kjo qetësi ka funksionuar vetëm pak kohë, sa është larguar gruaja. Dy orë më vonë Brahim Myrto është vënë në ndjekje të Halil Xuferaj dhe nga një distancë rreth 200 meter e ka goditur me armë automatike, por ai ka shpëtuar falë terrenit të thyer malor. Halil Xuferaj ka depozituar padi në polici dhe sipas informacioneve tona policia po punon për zbard-

hjen e ngjarjes, por deri tani askush nuk është vënë para përgjegjësisë penale. Është shpallur në kërkim shtetasi Brahim Selim Myrto.

Ngjarje të tilla e dëmtojnë imazhin e shqipërisë, tashti që ka marrë statusin e kandidatit për në BE, tha para ca ditësh zëdhënësjja e PD-së Laura Vorpsi, duke iu referuar një ngjarjeje kriminale ku shteti ose është i paafte të veprimi ose është pjesë e krimeve.

K.U







filo-fashiste, madje arriti edhe të hipte me ta edhe te Ballkoni i Bashkisë Shkodër, por kjo është një histori me vehte, që do ta trajtojmë në një numër tjetër.

Na vjen mjaft çudi se si biografistëve e analistëve të Migjenit, një ish lexuesi e kritiku rektifikues të Illyrisë & vazhduesve botues trashigimtarë të tij të veprës posthume; pastaj analizuesit të imtë, dr. Moikom Zeqos (i cili i kishte patur edhe privilegjin për të konsultuar disa nga dorëshkrimet origjinale të Migjenit, në Arkivin K. Q. të P. P. SH.); e më në fund biografistit të Enver Hoxhës, Blendi Fevziut,

i kanë shpëtuar gjithatë vogëlsira... Në disa letërkëmbime qoftë me Illyrian, me Minervën, me vetë botuesin Ismail Mal' Osmani edhe me Botën e Re, Migjeni ishte ankuar me shkrim për disa gabime, qortime e deformime teksti. Letër këmbimi i Migjenit me botuesin Ismail Mal' Osmani ekziston dhe ne e kemi botuar. Po ashtu gjenden përgjigjet e redaktuesit të gazetave, për ankesat e Migjenit. Pse nuk u botuan ato nga kritika e analistët e Migjenit?!



Por, cilat ishin ato gabimet tekstuale e ortografike dhe sa e ndryshonin ato Migjenin original në

manoskript a kopje daktilografim, nga tekstet e botuara? Kjo ishte një detyrë e një komisioni kolektiv redaktorësh ekspertë dhe jo detyrë e një individi. Si çuditërisht i ashtuqajtur si "Babai ose Dekani i Migjenologjisë" më 1956-1957, mos ndreqiet, mos redaktimin dhe mos botimin e saktë, ia kishte rrasur arbitrarisht, **redaktonjësit të botimit 1954!** Paradoxikisht, ky shoku tashti për herë të parë, pretendonte se, po përdorte disa tekste manoskrite posthume, të ndryshuara, korrigjuara e redaktuara, me anëshkrime etj, nga vetë Migjeni në Itali, të cilat i kishte sjellë nga Italia

nga dr. Jakov Milaj. Ndërkohë, që ato manoskrite të Migjenit, ishin mbajtur në Syndyk dhe vetëm më 1956-1957, po lajmëroheshin për herë të parë, pretendohet që Gjovalin Luka duhej t'i kishte njohur! Por, si mund t'i kishte njohur, kur asnjë studiues nuk i kishte njohur e konsultuar?! Sa ndryshime tekstuale kishte Migjeni i 1954 me atë të 1957? Pse nuk u bënë disa nga ato ndryshimet tekstuale, që i propozonte bie fjala ajo Kritika e Nëndorit, Nr. 5, 1954?! Sa ishin të vlefshme komentet dhe analizat realiste të Gj. Lukës? Aq shumë i kishte djegur Enver Hoxhës, sa vendosi ta shumëzonte me zero

botimin e vitit 1954 dhe vetë personin ta torturonte e akuzonte me gjithfarë akuzash ultra ekstreme, madje edhe të pa shembullta...


Ndërkaq, dikush qysh nga viti 1954 ankohej se, nuk kishte studime e krahasime tekstologjike etj, dhe për një çudi (edhe turp) më të madh akoma na thuhet sot se, ky studim nuk është kryer! Ka edhe një problem tjetër. Kur një autor e boton si prodhim letrar një letër të fondit epistolar, në kohën e botimeve, ky hyn në prodhimin letrar. Por, kur fondi epistolar, mbetet intim, si rregull ky botohet më vehte dhe jo si prodhim letrar.



Materiale të shfrytëzuara nga Gjovalin Luka, për përkujtimin e Pol Vajan Kuturisë

Botimi i vjershës së Migjenit, nga Illyria, 7 mars 1936


Tregon gjëkafshë ky publikim i Illyrias?!



Redaksia e gazetës Illyria, 7 mars 1936, i kthen përgjigjen korespondentit Enver Hoxha

Botimi që mendohet si përkthimi nga Enver Hoxha

Shikoni dhe lexoni vetë se kush e qortonte Migjenin...



Premtimi për Migjenin e transferuar në Pukë...

Fotografia e plotë e Marubtit, shtator 1936, ku krahas Ernest Koliqit etj, flet edhe Enver Hoxha në emrin e djalërisë intelektuale antizogiste...

Edhe në kohën e kësaj fotoje në Stanet e Shmilit, Enver Hoxha nuk ishte ende personazhi kryesor si udhëheqësi i PKSH dhe i LANÇ. Mbante akoma pardseshun e bardhë të 1936-tës dhe Delikatën Nexhmije...

# Nënë Tereza në Republika Srpska

Nga Uk Lushi

“Të gjithë sa ishim të ulur në karriget e teatrit të Banja Llukës— boshnjakë, kroatë, serbë, maqedonë dhe shqiptarë— brofëm në këmbë dhe filluam të duartrokasim të ngazëllyer. Sikur të kishe qenë me ne, do ta kishe provuar atmosferën e mrekullueshme vetë miku im i dashur. Një sukses i madh i Nënë Terezës!”— po më thoshte ambasadori shqiptar në Bosnjë e Hercegovinë, Flamur Gashi, përmes Viber-it; unë në New York, e, ai në Sarajevë.

Ambasadori Gashi, një diplomat yni i klasit të parë, e kishte fjalën për shfaqjen “Majka Tereza- Svetica Tame” (Nënë Tereza- Shenjtëresha e Errësirës), e cila pas një premiere të jashtëzakonshme në Teatrin Popullor të Sarajevës me 19 qershor, ishte ftuar të paraqitej edhe para publikut të kryeqytetit të Republika Srpska me 15 korrik 2014. Drama e frymëzuar nga jeta e bamirëses me famë është një produksion i Shoqërisë Kulturore “Napredak” me regji të kroatit nga Bosnja Gradimir Gojer, bazohet në tekstin e maqedonasit Venko Andonovski dhe në të interpretojnë aktorë nga Bosnja-Hercegovina, Kroacia dhe Kosova. Rolin e Nënë Terezës e luan Kostadinka Velkovska, artiste e njohur e teatrit Kerempuh në Zagreb, ndërkaq ekipi realizues një rol i ka dhënë edhe aktorit shqiptar nga Prishtina Ilir Tafa. Projekti multinacional, multikonfesional dhe multikulturor prej nisjes së tij është mbështetur nga ambasadat e Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë në Bosnje- Hercegovinë. Të dyja premierat, si në Sarajevë ashtu edhe në Banja Llukë, janë parë nga personalitete kulturore, diplomatike dhe intelektuale. Pritet që pjesa teatrorë për fituesen shqiptare të Nobelit për Paqe do të nisë së shpejti një turne ballkanik dhe mbase do të inskenohet edhe në Republikën e Shqipërisë dhe Kosovës.

Në tetor të vitit 2011 në teatrin beogradas Bitef u dha performansa postmoderne “Patriotic Hypermarket”, një pjesë teatrale e përbashkët e artistëve ballkanas nga Beogradi, Prishtina, Shkupi dhe Tirana. Brenda dhe jashtë ndërtesës ishin të pranishme forca të shumta policore të cilat u desh të siguronin trupën teatrorë nga sulme të mundshme prej radikalëve nationalistë serb. Në fakt, në dy raste — me 2008, gjatë ekspozitës së veprave të artistit shqiptar Dren Maliqi, dhe— me 2013, gjatë ekspozitës së

dëshmime të vrasjeve të familjes Bogujevci nga paramilitarët serb “Škorpioni” në Podujevë me 1999, policia u detyrua të ndërhynte për të zbythtur egërshahët dhe vandalët. Në ekspozitën e Maliqit ata shqyen një punim ku portretizohej Adem Jashari, kurse në ekspozitën që rrëfen vizualisht masakrimin e 14 anëtarëve të familjes Bogujevci nga perspektiva e përjetimeve të pesë të mbijetuarve, shovinistët provuan ta digjinin godinën.

Fatmirësisht shfaqjet apo prurjet kulturore serbe apo tjera ballkanike që janë paraqitur para publikut shqiptar, (kudo në trojet tona), nuk janë pritur me kanosje dhune. Shumica e tyre kanë arritur dhe vajtur pa marrë vëmendjen e merituar dhe tek-tuk iu është hedhur ndonjë sharje nacionaliste primitive. Duke e pas përjetuar pushtimin serb dhe diskriminimin e disa popujve sllav që na kanë bërë shqiptarëve me dekada, e kuptoj shumë mirë hezitimin dhe zemëratën e bashkëkombësve tonë kur vjen puna te shkëmbimet dhe qarkullimet e vlerave me popujt joshqiptar në gadishullin tonë, e posaçërisht me serbët. Kjo u pa sidomos me rastin e paraqitjes së një muzikanti serb në një televizion të Tiranës para ca muajsh, paraqitje kjo redaktoriale e dështuar ndërsa u vendos që serbi të këndonte në një emision dedikuar melosit shqiptar, mirëpo, në anën tjetër, prezantimi i artistit serb është plotësisht i arsyetueshëm nga aspekti i njohjes kulturore të tjetrit. Si shpesh herë, disa hamulitës shqiptarë nuk e lanë pa e shfrytëzuar precedentin dhe bile tentuan të nxisnin urrejtje duke përhapur gënjeshtër mbi gjoja dallimet e shkallës së patriotizmit midis Tiranës dhe Prishtinës. Padrejtësitë që na janë bërë shumicës dërmuese nga ne duhet të dritësohen duke ndjekur rrugët legale dhe duke kërkuar shpagim financiar për dëmet materiale dhe humbjet e dhimbshme njerëzore, ama ndërshkëmbimet me kombet tjera nuk duhet të ndalen.

Ka mjaft radikalë edhe në popullin tonë të cilët dëshirojnë dhe barabar punojnë që të mbyllemi nga marrje- dhënia me popujt tjerë. Veçimin ata e arsyetojnë zakonisht ose me argumentin e ruajtjes së “pastërtisë” së kulturës dhe civilizimit shqiptar, ose me argumentin se popujt tjerë ballkanik nuk na i duan vlerat tona sa ne të tyret dhe së këndejmi, sy për sy e dhëmb për dhëmb, edhe ne duhet t’i refuzojmë të tyret.

Kjo mënyrë e të rezonuarit është edhe e paleverdishme edhe shenjë inferioriteti pikësëpari për

kombin i cili vendos ta praktikoj atë. Pjesëtarët e një kombi të ditur duhet të orvaten të jenë prodhues të sa më shumë vlerave, siç duhet të jenë kërkimtarë të jenë edhe konsumues të vlerave të veta dhe të të tjerëve. Duke qenë edhe krijues edhe nevojtarë të vlerave, kombet e zgjuara e dinë që vlera fisnikërohet kur vihet në ballafaqim me vlerat më inferiore apo superiore të të tjerëve. Kombet moderne bashkëpunojnë me të tjerët sepse ashtu e ngritin cilësinë e vlerave të tyre ndërsa konsumojnë madje edhe vlerat, që, për arsye të përparësive krahasuese apo çfarë do qofshin arsyet, nuk i kanë apo nuk munda krijojnë. Dikush mund të thotë, po, ja filan kombit ballkanik nuk i interesojnë vlerat tona. Mirëpo humbja është e atyre që nuk interesohen, ngase ti ja njehe avantazhet dhe disavantazhet tjetrit dhe gjithsesi do të përfitosh nga kjo njohje, kurse ai nuk i njehe tuat. Nuk duhet ndier i frikësuar e as inferior për t’u hedhur në lo-

gun e vlerave dhe dallimeve racionale dhe globale. Secili komb ka diçka të shkëlqyeshme për të ofruar dhe secili komb ka nevojë për të marrë diçka të shkëlqyeshme nga të tjerët. Dallimi se ku gjendet një komb në rangimin e arritjes përcaktohet shumë nga pranimi i këtij ligji të pashkruar lidhur me dobinë e shkëmbimeve kulturore, shkencore, sportive..., e deri gjenetike.

Para 86 vitesh, që të kthehemi te fillimi, me 1928, një vajzë e ndruajtur 18 vjeçare e quajtur Agnes Gonxhe Bojaxhiu vendos të lëshojë Shkupin e saj, të lë prapa nënën e ve dhe të niset për Irlandë në Misionin e Motrave Loretto për të mësuar mbi jetën. Një vit më vonë ajo shkon për herë të parë për të shërbyer në Darjeeling të Indisë ku nis përkushtimin e saj të devotshëm për t’i ndihmuar të varfrit e botës dhe fillon të njihet si Nëna Tereza. Brenda 68 vitesh, bija e brishtë shqiptare e Nikollë dhe Drane Bojaxhiut shndërrohet në

simbol planetar i të tashmes dhe ardhmes njerëzore. Ndonëse tërë jetën përballë errësirës, Nënë Tereza kishte hapur shpirtin dhe mendjen kundrejt njerëzve tjerë dhe duke shkëmbyer vlerat e saj me të tjerëve, ajo mbërriti t’i jepte kombit shqiptar një vlerë universale të përhershme. Prandaj, “Majka Tereza- Svetica Tame”, me 15 korrik natyrisht që do të ngriste në këmbë së bashku boshnjakë, kroatë, serbë, maqedonë dhe shqiptarë midis Republika Srpska, ku deri para disa vitesh boshnjakët, serbët dhe kroatët priteshin e vriteshin me njëri- tjetrin thua se fati i universit varej nga lufta, e jo paqja mes tyre. Urat janë më të dobishme dhe rëndësishme se sa kufijtë dhe kudo ka njerëz menjepur dhe zemërgjerë është e mundshme të hiqet një copë kufi dhe të ndërtohet një urë, derisa, ndoshta, një ditë, jo fort të largët, të mos ketë kufij fare.



# Vetëshembja e Maqedonisë është afër

Nga Aleksander Cipa

Mediat shqiptare, së pari në Maqedoni dhe njëherësh edhe në Shqipëri e Kosovë, së fundi, për shkak të protestave të ndezura pas dënimit të gjashtë shqiptarëve me burg të përjetshëm për të ashtuquajturin proces “Monstra”, i janë rikthyer tekstit të Marrëveshjes së Ohrit në vitin 2001. Kanë kaluar 13 vjet nga nënshkrimi i asaj marrëveshjeje dhe faktori politik dhe sidomos politika institucionale në këtë shtet tekanjoz dhe provincial në mendësi, qëllimisht e kanë vonuar e harruar përmbytjen dhe implementimin e saj. Ripërmendja prej kryeministrit Edi Rama e kësaj marrëveshjeje dy ditë më parë, shkaktoi jo vetëm reagim nervoz e agresiv, të partisë së kryeministrit Gruevski, por shtoi diçka e cila e pozicionon këtë politikan grindavec, sikur të jetë opozitar i Kryeministrit të Shqipërisë. Në deklaratën e partisë së tij citohet: “Nuk do jesh gjatë Kryeministër i Shqipërisë...”. Kjo deklaratë dhe sidomos reagimet e protestuesve shqiptarë në Maqedoni, e përjashtojnë kuptimin nacionalist të reagimit të shtetasve shqiptarë. Madje vetë këta qytetarë po ia dalin të sqarojnë dhe vërtetojnë se në protestat e tyre nuk është motivi fetar dhe ndonjë shtysë tjetër radikale fetare që po e shpërthen situatën. Prova reale dhe plotësisht e besueshme mbetet ndjeshmëria e lartë e shtrirë në të gjitha qytetet ku jetojnë shqiptarët dhe prijësia e këtyre protestave prej të rinjve dhe përfaqësuesve që kërkojnë dhe dëshirojnë një përfaqësim më dinjitoz e me të drejta të plota barazie si shtetas. Shpalosja dhe shtimi i flamujve

kombëtarë në këto protesta nuk e shton simbolikën apo peshën frymëzuese të kombëtarizmit, por thjesht, merr semantikën e plotë të dëshmisë për të drejta të paplotësuara të njësisë tjetër etnike bazë të këtij shteti. Te kjo dëshmi, mediat shqiptare, por sidomos ato ndërkombëtare dhe rajonale, në ditët e ardhme, do të jenë më të fokusuar. Në dy ditët e para, shumë prej mediave dhe opinionëve të Kosovës dhe Shqipërisë, reagueshan me skepticizëm ndaj shfaqjes së disa flamujve arabë dhe simboleve të veçanta fetare. Dhe me të drejtë, diçka e tillë jo vetëm do të komprometonte qëllimin e kërkesave për drejtësi pa selektivitet dhe barazi shtetasish të etnive të ndryshme në këtë vend, por do të krijonte argument dhe arsye për një goditje imazhi ndaj shqiptarëve myslimanë. Në këtë skepticizëm u përfshimë edhe ne gazetaret dhe opinionistët e Tiranës. Mirëpo publicistët dhe mendimtarët prezentë në jetën publike dhe atë mediale të shqiptarëve në Maqedoni, reagueshan të parët ndaj këtij dizinformimi dhe simbolikave komprometuese, të cilat u zhdukën në ditët pasuese të protestave në Shkup apo Tetovë. Fjalimi i shkrimtarit dhe publicistit Kim Mehmeti para protestuesve të mbështjellë me flamuj kombëtarë dhe sidomos pohimi i tij se çdo simbolikë tjetër e huaj në këto protesta është antishqiptare dhe kundër qëllimit për drejtësi e të drejta të barabarta, është kundër shqiptarësisë, merr vlerën e një sqarimi të plotë dhe pa ekuivokë. Por matanë ilaritetit të parë të simbolikës së futur në mënyrë të dyshimtë dhe qëllimit real prej të cilit shpërtheu protesta e shqiptarëve, ka diçka shumë më përbajtësore. Kjo

përbajtje dhe substanca reale e saj, klasën politike bietnike në Maqedoni dhe krejt shoqërinë, duhet t'i bindë shpejt dhe pa dyshim se fjala është për diçka më komplekse dhe që pashmangshmërisht kërkon një proces të ri reagimi dhe ndryshimi. Kjo është një herë pa të dytë! Shqiptarët po e nisnin me qytetari dhe europianizëm procesin për një re-



alitë që është i dënuar të mos zvarritet apo injorohet më. Madje duhet thënë se edhe pse klasa politike shqiptare është e pakonsultuar mes vedit në tërësinë e selive të saj partiake apo institucionale, si në Shkup ashtu edhe në Prishtinë, e sidomos në Tiranë, procesi që është shfaqur jo vetëm e problematizon qëndrimin e derisotëm të udhëheqësve, por e bën atë edhe më të sfiduar. Kur themi e bën më të sfiduar, kemi parasysh faktin që protestuesit në Shkup mësynë me gurë dhe akuza selinë e BDI-së, sikundër përqeshën edhe deklaratën e Menduh Thaçit, kryetarit të PDSH-së, se ata janë elita dhe

“paria” e shqiptarëve.

Gjithë faktorët politikë dhe ata ekstrapolitikë në hapësirën shqiptare duhet të marrin në konsideratë se protestat e shqiptarëve në Shkup janë pjesë e protagonistimit të rinisë shqiptare. Një protagonistim, i cili në historinë e konfliktit të vitit 2001, kur nisi lufta që u mbyll me nënshkrimin e Marrëveshjes së Ohrit, kishte

një kundërpërgjigje të nacionalistëve maqedonas me deklaratën dhe protesta qesharake qytetarësh, është një akt vetëndëshkimi jo vetëm politik, por edhe në raport me institucionalizmin ndërkombëtar dhe garantitë eurorajonale. Por pavarësisht këtij faktori kaq kompleks e me kaq komplekse, protesta e shqiptarëve në Maqedoni është jo një pretekst për acarime etnike, por një refuzim qytetarësh ndaj një realiteti me diskriminim dhe pabarazi shtetasish të së njëjtës republikë. Ajo republikë është e pandreqshme në asimetrinë dhe pabarazinë e vet. Një kryeministër grindavec dhe megalomani si Gruevski nuk mund ta kuptojë e aq më tepër ta pranojë këtë gjë. Për këtë arsye kaq themelore, bashkëjetesa politike në të njëjtën qeverisje e BDI-së së Ali Ahmetit në mos ka përfunduar, nuk mund të vijojë sikundër deri tani. Kësaj bashkëjetese i është vënë në dispozicion një platformë e re e dalë dhe që do të formulohet prej vullnetit të qytetarëve që nuk e njohin më drojën. Platforma – monstër e kesi

bashkëqeverisjeje e ka mbyllur kohën dhe jetën në Maqedoninë fqinje. Këtë po e konfirmojnë shqiptarët e dalë në shesh dhe në rrugë si qytetarë të dinjitetshëm dhe pa braktisur konstruktivizmin e shtetasve që kërkojnë barazi e njëjtësi sjelljeje e shërbimi prej shtetit. Ata duan që ai shtet të pushojë së qeni me dy standarde, në të kundërt Maqedonia, nëse mbetet në padëgjueshmëri dhe kryeneqësinë tipike të klikës politike të maqedonasve të deritanishëm, ka për të jetuar dhe vuajtur finalen e inekzistencës së vet.

## Njëra nga sfidat më serioze të një Rilindjeje të vërtetë

Reagimi sistematik grek, në dogana, në dëm të një komunikimi normal për mijëra e mijëra qytetarë shqiptarë: Fëmijë, gra, të moshuar, emigrantë me probleme dhe halle nga më alarmantët ka qenë gjithnjë një reagim aspak burokratik, teknik apo defektsh nga më të ndryshme, por ka qenë dhe do të jetë një strategji e vet shtetit grek për të qenë kurdoherë në raporte superioriteti me shtetin shqiptar, në kuptimin e asaj filozofie skllavëruese, që mjerisht prej kaq vitesh ushqehet nga sjellja mazokiste e vet klasës sonë politike. E theksoj këtë fakt, aspak për herë të parë, sepse cilado force politike, që ka ardhur në pushtet, mjerisht, ka heshtur apo thjesht është shtirur sikur po reagon ndaj akteve antishqiptare të grekëve, lexo të qeverisë së tyre, në kurriz të dinjitetit të shqiptarëve.

Kjo frymë ka berë që, në emër të arritjes së kësaj apo asaj mbështetjeje nga pala greke, ndryshe të ketij apo atij objektivi në proceset e integritetit, shqiptarët, lexo klasa jonë politike, ka pranuar në heshtje denigrimin e personalitetit të shqiptarit deri në diskriminim: Vrasjet, përcudnimet me emrat, tash së fundi edhe me toponimet, janë faktikisht provat më ekselente të presionit grek për ta ruajtur si rezervat të interesave të veta shqiptarinë duke

njohur etjen për të mbajtur me çdo kusht pushtetin, pra etjen partitokratike tek cilido ekzekutiv yni në keto 22 vjet Reagimi i Kryeministrit të ri, në pritje, Z.Rama apo edhe i Ministrit të Jashtëm, Z. Bushati ndaj brutalitetit doganor, ditët e fundit, kam bindjen se është prologu i asaj Rilindjeje që pritet edhe në aspektin diplomatik filluar me fqinjin grek dhe cilindo partner. larg frymës së kultit të cilësdo fuqije politike, si një idhujtari skllavëruese, Modeli Rama, në këtë vështrim, shprej të shpalosë vetveten me dinjitet duke na dhuruar edhe në këtë aspekt një risi diplomatike.

E them këtë, sepse megjithëse investimet greke në Shqipëri gjatë këtyre dekadave kanë rrokur ndër vite edhe shifrën mbi 60% krahasuar me partnerët të tjerë, ndërkombëtarë, trajtimi i shqiptarëve ka qenë përherë mizerabël: Shqiptari nuk guxon të flasë publikisht, në gjuhën e vet, me shqiptarin, shqiptari që derdh aq shumë djersë dinjiteti në ndërtimin e Greqisë së Re nuk guxon të artikulojë as emrin e vet, emrin që i vuri nëna apo babai kur erdhi në jetë, shqiptari (këtu kam parasysh çamët) që po investon djersën dhe mundin e tij në Greqinë e diteve tona nuk guxon të kujtojë as varret e të parëve, nuk guxon të shkllasë as në trojet e veta nga lloj-

lloj cenesh të prodhuara nga vetë strukturat qeverisëse greke.

Dhe, sikur të mos mjaftojnë të gjitha këto “heshtja ndërkombëtare ndaj gjuetisë antishqiptare greke, me vrasje si të kafshëve në pyll të shqiptarëve, bëhet akoma më trishtuese, ndryshe si një aparteid ndaj zezakëve të Afrikës, kur këta ndërkombëtarë evropianë bëjnë të shqetësuarin për gjendjen e komunitetit rom, apo të minoritetit grek në Shqipëri, edhe pse një shqetësimi i tillë nuk ekziston, problemi në fjalë i marrëdhënieve greko-shqiptare vjen tejet alarmues. Dhe, kur, krahas kësaj kujtojmë edhe heshtjen ndaj genocidit në Çamëri, 70 vite më parë, apo para ekzekutimeve policeske në këto 20 vitet e fundit, kjo heshtje vjen si një bashkëfajësi evropiane ndaj shqiptarëve: Ky është mjerim i të ashtuquajturës “urtësi evropiane”. Ky është gjymtim i të drejtave të njeriut që kërkon Evropa. Ky është kriminalitet me miratim edhe të vetë Evropës, 100 vjet më parë në Konferencën e Londrës” (H.Zane gazeta “Telegraf”, më 23.07.2013)

A ka më kulminacion poshtërues se sa momenti kur një shqiptar nga Filati, djali i një antifashisti të njohur çam, gjak i një kombi që ka dhënë gjak më shume se asnjë komb, për frymë, për lirinë kundër nazifashizmit, të kërkojë ndihmën e ambasadorit amerikan Arvizu që të shkojë në Filat(Çamëri)?!! Dhe brenda se keqes nga shteti grek, personalisht, shoh dhe besoj të mos e shoh më, ka qenë edhe sjellja poshtëruese e një mazhorance në emër të të ashtuquajturës së një diplomacie të matur, faktikisht përpjekjes në çdo rrethanë për të jetëz-

jatur kulltukun qeverisës, klientelist dhe aspak shëndetin e demokracisë shqiptare. Çdo sjellje apo qëndrim politikani apo qeverie që robëron popullin e vet nuk është tjetër vetëm sjellje prej pushtuesi ndaj kombit të saj, ndaj popullit që e ka votuar, ndryshe një tallje cinike dhe nëpërmkëmbje të vullnetit të Sovranit që i besoi votën e tij. Kjo përvojë mjerane, kjo traditë e ligë, e pabesë ndaj popullit të vet, kam bindje që do të jetë hipoteza më serioze për ndërtimin e marrëdhënieve me dinjitet, nga qeveria Rama, në thelbin e tyre fizozfik, politik, diplomatik dhe aspak si hipokrizi civile nën ethet e mazohizmit që e ka cënuar keqas dinjitetin e marrëdhënieve mes dy shteteve fqinje..

Interesi kombëtar vazhdon të jetë pika më e dobët e vet Bashkimit Evropian, kësaj fuqije të madhe progresuese, krahas SHBA, merret me mend se çfarë statusi karikaturë, skllavëruese fiton ardhmëria e një vendi të vogël si yni, nëqoftëse qeveritarët tanë, politikanet tanë, klasa jonë politike në tërësi dhe veçanarisht mazhoranca qeverisëse harron këtë Thembër Akili brenda vetvetes duke injoruar thelbin e misionit të saj në një shoqëri të hapur: Përmirësimi maksimal i jetës ekonomike, kulturore, shpirtërore e qytetarëve të saj, të cilët vendin e tyre kanë të drejtë ta shohin jo në rrugën e një “supërkolonie”, në shinat e një rrugëtimiti skllavërues është detyrë nr.1 e shtetit tonë ligjor. Kujtoni kalvaret prej disa kilometrash masakrues në kufirin me Greqinë, kur qarjet e foshnjeve, britmat e të pamundurëve nga mosha, nga shëndeti, urgjenat e hallexhinjve të pafund në pritje skëterrosëse në

automjetet e tyre shoqëroreshin me cinizmin brutal të autoriteteve greke, edhe pse ekrameve tona dhe të botës, qeveritarët tanë prej 22 vitesh byrleken për marrëdhënie miqësore emblematike, të të nderojë tjetri, duhet më parë të nderosh vetvetenky është kodi diplomatik i komunikimit në Epokën e Dialogut dhe të Integritetit si vlerë demokratike:

Të dua ty, sepse dua veten, respektoj lirinë tënde, sepse e urrej skllavërimin ndaj të tjerëve, po aq sa ndaj vetes, aq më shumë si sjellje e më të fortit ndaj më të dobëtit.

Çështja e integritetit evropian nuk mund të trajtohet si marrëdhënie mes gjykatës, Evropës dhe fajtorëve, vendeve të Lindjes, që i kishin ikur si djem plangprishës kontinentit mëmë, - theksonte Václav Havel -, përkundrazi marrëdhënet mes palëve duhen parë vetëm si barazi dhe përgjegjësi e përbashkët e tyre, si rol barazisht aktiv i të dy palëve..Mënyra e të parit të gjërave për t'iu bashkangjitur më të fortit të momentit, ndryshe “për t'iu zhvatur” diçka në formën e një fëmije që pret të vlerësohet, se sillet mirë dhe me edukatë, është pikërisht burimi i prapambetjes sonë në Integritetin evropian”. Vetëm tek kjo filozofi, si filozofia e një Rilindje të vërtetë tek e cila sot besojnë shqiptarët, pa le ç'përrallisim oborratet e skemave të modelit të shkundur nga pushteti me votën plebeshtarë të qershorit 2013-të, personalisht e shoh ardhmërinë tonë normale edhe në aspektin problematik me shtetin grek.

**Kadri Ujkaj**

# Nostalgjia për Enver Hoxhën

Nga **Ardian Ndreca**  
Ambasador në Vatikan

Tregon Svetoni, historian romak i shekullit II, sesi mbas vdekjes së Neronit nuk munguen ata që për vite rresht ia zbkuronin vorrin me lule dhe afishonin në vendet e caktueme publike shembelltyrat e tija dhe kopjet e dekreteve sikur të ishte ende gjallë.

Gjithë koha ndërmjet nesh dhe Neronit asht e mbushun me devocione dhe nostalgji të çmendunish për individë që botmisht dihet se i kanë shkaktue njerzimit kryesisht vuetje dhe mundime. Ende sot ka nostalgjikë të Hitlerit, Stalinit, Pol Potit, Idi Amin-it... Enver Hoxhës e shumë të tjerëve që kanë qenë mjaft larg qenjes "njerëz mes njerëzve".

Fenomeni i nostalgjisë vërehet edhe tek ne, pothuajse në çdo përvjetor të vdekjes së diktatorit Enver Hoxha. Nuk ka asgja për t'u çuditë nëse mbasardhësit e tij biologjikë e mbrojnë, pse ata janë ndër të paktit që nuk e kanë pasë frikë qenjen e tij sa ishte gjallë, nga ana tjetër nuk përban tashma një domosdoshmëni për ta, pasja e një ndjenje morale që t'i bante me ndie sadopak keqardhje për viktimat e pafajshme e të kota që ka shkaktue prindi i tyne.

Ajo që ban përshtypje asht gatishmënia e publikut dhe e disa mediave me ndie përrallat e sheqerosuna të bashkeshortës dhe fëmijëve të diktatorit Hoxha.

Përgjatë shekullit të kaluem Enver Hoxha ka qenë udhëheqësi ma i pakuptimtë në Europë, qenja dhe veprimi i tij politik, thjesht, kanë damtue vetëm popullin e tij, pa i sigurue – siç e tregoi vetë koha – asnjë të ardhme tjetër, që të mos ishte mizerja materiale dhe morale.

Izolimi i tij ekstrem e bante të pakuptimtë dhe të padamshëm politikisht për botën perëndimore, të bezdisshëm por të tolerueshëm për fqinjët, të damshëm deri në vdekje për të vetët.

Dhuna që ai dhe sistemi i tij ushtroi në kohë paqet ndaj një populli të tanë ishte krejtisht e pajustificueshme, të mirat e pandehuna që paska prodhue ajo dhunë janë të pavërtetueshme historikisht.

Sa për rolin e tij gjatë Luftës së Dytë mund të themi se qëllimi i tij, jo i të gjithë atyne që luftuen përkrah tij, ishte marrja e pushtetit. Këtë gjë e treguen mungesa e skrupujve, oportunizmi i skajshëm, vrasjet pa kriter të shokëve të tij komuniste, gjatë dhe sidomos mbas konfliktit botnor. Do të ishte shumë naive po të mendonim se roli i Enver Hoxhës në rikthimin e sovranitetit të Shqipnisë ka qenë vendimtar. Fatet e Luftës së Dytë botnore vendoseshin dikund tjetër dhe jo në shkrepat apo në rrugët mesjetare të Shqipnisë.

A do të vijonin, po të mos kishte qenë Enver Hoxha me gueriljet e tija, trupat gjermane me ndejt në vendin tonë mbas kapitullimit pa kushte të Gjermanisë naziste? Vetëm disa historianë qesharakë mund të pohojnë të kundërtën. Në

qoftë se veprimi i tij ushtarak do të kishte pasë sukses, atëherë mbas çlirimit të Shqipnisë, në Greqi do të duhej të kishte ende trupa gjermane, por jo, Shqipnia u lirue prej gjermanëve në tërheqje dhe nuk u çlirue prej një frikacaku që nuk mori pjesë

me ndihmën e tyne Kanalin e Korfuzit dhe aniqsoi vendin me aleatët. Por nuk u mjaftue me kaq, si njeri pa njohunitë elementare të artit ushtarak, ai spostoï frontin grek të luftës mes monarkistave dhe komunistave në territorin shqiptar, tue u

dit tonë, duke qenë se një konflikt i mundshëm mes superfuqive do të zhvillohej edhe në territorin shqiptar, me pasoja katastrofike për vendin tonë.

Oportunizmi i tij i pashoq politik, nuk e pengoi menjherë mbas

eksperimenteve të pangjashme politike solli një përkeqësim gjithnjë e në rritje të gjendjes ekonomike të shqiptarëve. Izolimi nga rrjedha e zhvillimit të shkencës, arteve dhe kulturës botnore atrofizoi forcat dhe çoi pak nga pak në krijimin e "njeriut të ri socialist", një hibrid i frustruem i terrorit radikal, fryt i injorancës, dhunës dhe fanatizmit ideologjik.

Asht qesharake tentativa me ia mveshë Enver Hoxhës dhe regjimit të tij disa të mira që vetë koha i sjell me vete kudo. Në qoftë se elektrifikimi i vendit do të kishte promovue kultivimin e shpirtit të lirisë dhe jo indoktrinimin dhe rranjosjen e gënjeshtres së ngritun në rang sistemi, atëherë do të kishim folë për një arritje të mirëfilltë. Liria personale nuk asht e zëvendësueshme prej llampës elektrike, ashtu siç nuk asht e zëvendësueshme drita e diellit prej dritës elektrike.

Ka disa të këqija radikale që mbahen gjallë prej disa të mirash të vogla, ashtu siç mbahet gjallë zjarri shkatërrimtar prej pranisë së oksigjenit.

Dekadat e komunizmit e rreshtuen Shqipninë, përse i përket zhvillimit dhe pasunisë së individit, në një linjë me vendet ma të mbrapambetuna afrikane, komunizmi despotik shqiptar nuk ruente asnjë tipar të frymës së komunizmit perëndimor. Çdo e mirë spontane natyrale e shqiptarëve ishte tjetërsue nën vulën e një ideologjie që identifikohej me kultin e një personi të vetëm. Mund të themi se frytet e komunizmit shqiptar, siç ishte propagandue, i gëzonte vetëm një lagje e Tiranës e mbiquejtun "Bllok". Andrra e komunizmit me realizue parizin në tokë ishte vërtetue vetëm për një grup të vogël burokratësh totalisht të paaftë për nevojat e kohës, të pamoralshëm dhe shpeshherë kriminel, pse vetëm ata thithnin simbas standardeve të propagandue nga regjimi frytet e gjithë djersës dhe sakrificave të shqiptarëve. Megjithatë, tue qenë se Shqipnia nuk ishte një shtet i së drejtës por një sulltanat arbitrar, as ata nuk ishin të sigurtë. Kjo ishte gjendja katastrofike e fundit të viteve '80.

Seria e madhe e bashkëpunëtorëve të Sigurimit, e përfituesve të autorizuem të pasunive të vendit, e oportunistave të pamoralshëm që u aktivizuen në politikë mbas vitit 1990, i siguroi udhëheqjes komuniste një tranzicion të gjatë e të parrezikshëm që zgjati ma se 20 vjet. Asht paradoksal fakti, por tranzicioni nga "mesjeta" otomane, në vitin 1912, deri në themelimin e Shtetit shqiptar, 1920, ka qenë ma pak problematik se ai nga komunizmi "alla enver hoxhë" në një shoqni liberale që ende na mungon. Fakti që sot ka prej atyne që guxojnë me rehabilitue Enver Hoxhën, mvarret edhe prej zhgënjimit që sollën me vete pinjojtë e tij që drejtuen tranzicionin ma poshtnues të historisë së kombit shqiptar.



në asnjë betejë.

Edhe mbas luftës Enver Hoxha nuk bani asgja për ruejtjen e sovranitetit të vendit. Dy territoret shqiptare që duhet të diskutoheshin në mbarim të luftës ishin Kosova dhe Çamëria, por nuk ka asnjë dokument historik që të vërtetojë impenjimin e Hoxhës në këtë drejtim ose të paktën, të paktën, në ngritjen e zanit në favor të të drejtave elementare të shqiptarëve të atyne viseve.

Ndërkaq ai ua dorëzoi jugosllavëve ekonominë kombtare, minoi

ba shkak i ofensivës greke që shkaktoi viktimat të shumta ushtarake dhe civile ndër ne. Pra, në një linjë me qeverinë fashiste të vitit 1940, Enver Hoxha provokonte 9 vite ma vonë Greqinë tue lejue sulmet komuniste greke prej territorit shqiptar dhe tue rrezikue randë sovranitetin e vendit.

Ma vonë, vendosja e një baze sovjetike në Vlorë e shndërroi Shqipninë në një karakoll sovjetik në Mesdhe, tue rrezikue, në klimën e Luftës së Ftohtë, sigurinë e ven-

prishjes me sovjetikët me deklarue se mbështeste ushtarakisht Jugosllavinë dhe pranonte mbështetjen jugosllave në rast agresioni nga ana e kampit socialist.

Planet e tija të pandehuna me sulmue Jugosllavinë në fillimet e viteve '80 mund t'i besojnë vetëm ata që kanë një ide të forcave ushtarake të dy vendeve, të ngjashme me idenë që mund të kenë për luftat asiro-babiloneze.

Shkatërrimi i ekonomisë kombtare si pasojë e izolimit dhe e

# Harvard njofton zbulimin: Shikoni "Jehonën e Big Bang!"

Publikohet detektimi i valëve gravitacionale që shënon zbulimin epokal kozmologjik. Zbulimi u njoftua prej ekspertave të Qendrës së Astrofizikës Harvard Smithsonian, që zbuluan se kanë kapur jehonat e Big Beng të 14 miliard viteve më parë nëpërmjet një teleskopi me mikrovalë të vendosur në polin Sud.

Zbulimi i këtyre valëve gravitacionale paraqit elementin e fundit, të patestuar akoma prej teorisë së përgjithëshme të relativitetit të Albert Ajnshtajnit e do të mbushnim një boshllëk të madh në kuptimin tonë se si është lindur Universi. Njiheshin katër tipet e forcave në natyrë: Forcat elektrike, magnetike (Maksvelli i lidhi këto forca, pra dhe fushat në ato elektromagnetike), bërthamore dhe ato gravitacionare. U gjet një emër për thërmijet që realizojnë bashkëveprimin gravitacionar, u quajtën gravitone, por asgjë më shumë se kaq... U përpoq shumë Ajnshtajni të bëjë lidhjen midis


qiellit, që njihet si "Vrima e zezë e Sud-it", që ndodhet jashtë galaktikës dhe ku ka pak lëndë extragalaktike për të ndërhyrë me atë që është e mundur të shohësh nëpërmjet instrumentave modernë. Kështu njofton axhensia Asca.

U gjetën provat e para të inflacionit kozmik.

Deri tani ishte vetëm një hipotezë. Në teleskopët ku duhet të detektoheshin (zbuloheshin, nga të tjerat) valët gravitacionale me gjatësi valore shumë herë më të vogla se sa madhësia e një atomi, njëkohësisht arrijnë valët e dritës që vijnë nga burime të shumta ndërgalaktike, që janë me biliona, midis burimit dhe detektorit (zbuluesit). Këto valë drite janë me intensitet dhe gjatësi vale shumë herë më të madhe se sa valet gravitacionale, që duhej të detektohen. "Janë mbledhur provat se Gjithësia (Universi), para 14 miliardë vitesh, pas aktit të lindjes me Big Bang, pësoi një zgjerim të papritur, të ashtuquajturën Inflacion, që zgjati

Bang ka lënë, si dëshmi të ekzistencës së tij, një radioacion fosil, që përshkon të gjithë Universin e që paraqet mbetjen, tashmë të ftohur, të energjisë së lartë të çliruar nga Shpërthimi Fillestar. Kjo ka ndodhur rreth 370 mijë vjet pas Big Bang, kur drita u nda nga materia elementare dhe filloi të përhapet në hapësirë.

Një nga pamjet e jashtzakonshme të zbulimit është se antena gravitacionale ndërtuar qëllimisht për të kapur këto tip valësh të prodhuara prej një lëvizjeje të madhe mase, deri tani nuk ishin në gjendje t'i kapnin. Grupi kërkues i Bicep2 arriti t'i shohë me një teleskop për mikrovalë, qoftë nëpërmjet një efekti sekundar. Suksesi i astrofizikanëve të Harvard është i dyfishtë: vërtetimi i parë eksperimental i procesit inflacion të Universit të lashtë (primordial), por edhe një kërcim të fuqishëm së prapthi drejt fillimit të kohës. Deri tani kishim ndalur tek 370 mijë vjet pas Big Bang, koha kur drita filloi të shpërndahej, tani kemi arritur në



kësaj force dhe atyre të tjerave, por nuk arriti. Të gjitha këto forca realizojnë të gjitha bashkëveprimet në natyrë, pra mund të themi se ato drejtojnë Universin.

Valët gravitacionale janë rrudhat (nënkupto ato kreshta e barqe të valëve), që lëvizin në hapësirë - kohën e janë përshkruar si "dridhjet e para të Big Bengut". Zbulimi i tyre konfirmon një lidhje integrale midis Mekanikës Kuantike dhe Relativitetit të Përgjithshëm. "Zbulimi i këtij sinjali është një prej objektivave më të rëndësishëm të Kozmologjisë sot. Për arritjen e kësaj u deshën shumë njerëz dhe shumë kohë". Teleskopi që bëri zbulimin u drejtua në një zonë të

vetëm një fraksion të sekondës. Falë instrumentit të një teleskopi me mikrovalë, të quajtur Bicep 2, për herë të parë u regjistrua sinjali i inflacionit kozmik. Ishte pasdita e ditës së hënë 17 mars kur grupi i shkencëtarëve të kozmologjisë amerikane (astrofizikanët John Kovac e Chao - Lin Kuo, në Konferencën në Qendra Astrofizike e Universitetit të Harvard, në Boston) arritën në konkluzionin për atë që ishte njoftuar si një Zbulim më i madhi kozmologjik i kohëve të fundit.

-Kapja e këtij sinjali, shprehet Kovac, paraqet një rezultat shumë të rëndësishëm të kozmologjisë së sotme. Me aparatet që u përdorën zbuluan se Big

formimin e materjes, më saktë shndërrimin e energjisë në lëndë) detektimi i valëve gravitacionale që i takojnë përmasave kuantike, të cilat sqarojnë inflacionin, apo zgjerimin e Universit, mundësojnë lidhjen e Teorisë së Relativitetit të Përgjithshëm të Ajnshtajnit me Teorinë kuantike. Kjo tregon se po realizohet ëndrra e Albert Ajnshtajnit.

Këto që mbledhën me Bicep2, kur të konfirmohen prej grupeve të tjera shkencëtarësh, do të na lejojnë të themi se këto shkencëtarë janë kandidatët për një Çmim Nobel të Ri në fushën e Fizikës.

Sitki Çerekja  
Pedagog Fizike

# Kur shikon në thellësi...

Duke lexuar librin e kohëve të fundit "Kur dashurohemi me kultkonijunkturën, ndryshe Sindroma shqiptare e Stokholmit" të kritikut letrar Kadri Ujkaj gjykojmë nga stili i tij i shkruarit u ndjeva përpara një rastësie risi, ndoshta e pangjashme në studimet tona dhe përgjithësisht në botën e letrave shqipe, jo thjesht, për gjetjet e goditura filluar nga titulli i librit të tij, por me funksionalitetin estetik që ai i jep dritëhijeve, si një e tërë, në përjetimin kritik të thelbit të qenies sonë si konfirmim i së tërës: Si traditë, si art dhe kulturë, si histori dhe psikologji me vetëdijjen kritike:

Pa dyshimin progresist, nën kthetrat e entuziazmit si kultkonijunkturë në postmodernitet, siç po vazhdojmë në këto dy dekada, fatkeqësisht, po kryejmë atentatin më absurd ndaj vetvetes si komb, kur koha e shansit të madh, koha e "Shqipërisë-Zonjë", siç e ëndërronte Naimi, poeti ynë i mirënjohur, është pranë nesh më afër se kurrë.

Kritiku ynë nuk lexon, por qëmton. Ai nuk rrëshqet ndër faqet e librave, por ndalet aty ku përkon, ose nuk përkon me autorin. Dhe merr shënime, përzgjedh citate të cilat do t'i vlejnjë më vonë, në një temë, në një ese apo në një studim kritik për të mbështetur apo kundërshtuar me kurajo civile ata-ato, "hijet...": idolatritë, idhujt pa krena, kultet në epokën e postkulteve që riskojnë ngjitjen tonë në nivelet e civilizimit bashkëkohor.

Ky është Kadri Ujkaj, kritik letrar, eseisti dhe studiuesi disi i veçantë nga të tjerët, studiues apo kritikë në letrat shqipe, në ditët tona, kur çuditërisht kritika jonë letrare e mirëfilltë, shpeshherë, kur e kemi aq të nevojshme, po zëvendësohet me britmat, çjerrjet panergjike, pra sheqer dhe mjaltë ose me hysterizëm, pra farmak e zehër.

Filozofia estetike e Kadriut, si kritik apo eseist, nuk i ndan apo veçon të mirën nga e keqja, pra nuk është me përjashtimin brenda vetes d.m.th me parimin e ndarjes ideologjike, që lamë pas: Ose bardhë, ose zi. Kadriu i sheh të dyja, si objekt i shkrimeve të tij, të pandara brenda thelbit tonë: Edhe të bardhën, edhe të zezën. Posi të tilla ai i analizon dhe i interpreton si një e tërë, si tek qenia njerëzore, po aq edhe brenda vetë familjes apo shoqërisë, qoftë kjo edhe si shoqëri e hapur apo si realitet global.

Vetëm brenda këtij vështrimi, me këmbë në tokë, ai sheh edhe përspektivën e së ardhmes sonë si komb, si popull që ka të drejtën e padiskutueshme të rishikojë historinë, e vet, por kurrsesi ta rishkruajë, sepse, siç shprehej Konic, nënvizon me po kaq të drejtë kritikun Ujkaj, e kaluara nuk zhbëhet dot, sytë tanë dhe mendja jonë duhet të shohë vetëm përpara, nëse realisht duam të kapim kohën e humbur.

Pikërisht këtu qëndron e veçanta e këtij kritikun apo analisti në ditët tona. Në pamje të parë kritikun ynë të duket prolix dhe pak i vështirë për t'u "përtypur". Por edhe kjo s'është tjetër vetëm një veçanti e stilit të tij si studiues, kritik letrar, publicist apo eseist. Ai sheh dhe depërton aty ku shumëkush ja përton të futet duke i bërë ftesë lexuesit, sidomos atij të kualifikuar, për durim dhe mbi të gjitha guxim, guxim deri në fund guxim.

Në librin e tij "Kur dashurohemi me kultkonijunkturën, ndryshe Sindroma shqiptare e Stokholmit" ai ka zgjedhur të merret përmes gjuhës së esesë me të keqen e madhe që mund të na vijë si qytetarë apo si komb, nëse nuk nxorrem mësimet e duhura nga e djeshmja si koha e kulteve ideologjike apo e kultit të Njeshit, me të shëmtuarën luftën e klasave që na mjerroi deri brenda gjakut tonë duke na kthyer në armiq të vetvetes. Me shumë vend kritikun letrar Ujkaj na tërheq vëmendjen të gjithëve duke filluar edhe nga ajo pjesë që ai e ndjen si gjëja më e shtrenjtë nën diell-vendlindja:

"Kujdes, historia nuk do të shkruhej, nëse nuk ekzistonte frika se ato që harrohen mund të përsëriten", -

Modelin e më të mirës, në rrugën e komunikimit mes nesh, me vlerat tona sa lokale, sa kombëtare ai e sheh tek kulti i të kaluarës së pastër, si pasurim dinjitoz i identitetit tonë, jashtë çdo politizimi mes nesh, apo përjashtimi të individit apo të grupit për bindjet e veta ideologjike, si deri dje, duke riskuar spiralen drejt së ardhmes sonë evropiane.

Në fundit të fundit, a nuk na do edhe Evropa e Re pikërisht të tillë dhe kurrsesi si majmunër modernë në gjirin e saj, kur askush në Evropën moderne, - thekson kritikun ynë duke iu referuar Kadaresë-, nuk po bëhet gati të braktisë kombin e vet.?!?

Veçantia apo risia letrare e Kadriut, si kritik letrar novator, lexohet edhe tek esetë kushtuar Migjenit, Kadaresë dhe Dritëroit, falë një leximi ndryshe, që Kadriu i bënë veprës së tyre duke na sjellë dy profile të reja poetike: Një Migjen, poet postmodern, si Korife i Kohës së Njeriut-mbinjeri, me Njeriun-Zot dhe jo zotin mbi gjithçka, i aftë të kapërcejë vetveten, qoftë edhe duke e riskuar atë, si nevojë e afirmimit apo e ringritjes nga "balta", refleks i asaj estetike që Niçe do ta quante estetikë mashkullore,

Sikurse një Dritëro, që duke fituar mbi kufizimet e vet ideologjike, veti e gjenive të letrave, arrin të na dhurojë "Zhurmat e erëva të dikurshme" me personazh kryesorë, të dyzuar, apo me dualitetin shpirtëror aristotelian, i cili, jo thjesht, nuk është modeli i "heroit të ri", por, gjithsesi, antiheroi, individualisti, me moton "Bota ekziston vetëm brenda meje", ndryshe "kokëkrisuri" që preferon të jetë ai që është... dhe jo ai që duhet... i cili "suksesin kolektiv" e sheh vetëm si fillim i jetës" me sukses të vetmuar..."

Po kaq intrigues kemi edhe vizionin postmodern të Kadriut si analist bashkëkohor përsa i takon vizionit të tij postmodern ndaj patriotizmit... "Kujdes, rrofsha unë ngulmon njeriu postmodern. Atdheu e dua sa të më dojë ai mua", - na tërheq vëmendjen kritikun-analist me një shikim drejt thellësisë, larg sloganeve patriotike me të cilat jo pak abuzohet në ditët tona. Vizioni i tij mbi posthistorinë si epoka e postideologjisë dhe e postkulteve është vizioni postmodern i intelektualit shqiptar, që ngrihet kundër përjashtimit të tjetrit apo të grupit për bindjet e veta ideologjike.

Pikërisht kundër kësaj filozofie përjashtuese, si tharje brenda vetes apo si luftë e re klasash, si kult i Njesh-it, si kult i Besnikërisë së Mallkuar ndaj "Nënës-parti", si deri dje, qoftë kjo edhe si kultkonijunkturë demokratike moderne apo si nostalgji ndaj "Armikut të Çlirimit", ndryshe si sjellje tragjikomike me vetveten, që gjithsesi na kujton me neveri Sindromën e Stokholmit (1973) kur e dhunuara gjatë procesit të hetimit bie në dashuri me dhunesin e saj, pengmarrësin duke dalë në mbrojtje të tij përpara trupit gjykues., apelon libri i Kadriut duke na tërhequr vëmendjen:

Kush jemi... ku po shkojmë...?!?!

Kjo është kuintsentenca, si të thuash ideja kryesore apo mesazhi i këtij libri që aq mjeshhtërisht kritikun letrar she eseisti Kadri Ujkaj e koncentron në thënien e një patrioti, trimi dhe diplomati popullor si nënkolonel Mul Delia, ish-bajraktari i Hotit:

"Qeveritë dhe pushtuesit janë si uji që rjedh,

ne jemi populli që mbetemi këtu."

Fadil Kraja, "Mjeshtër i Madh"

# America – The Country of Freedom and of rights of people

We Albanians, as the most pro-American nation in the world, maybe also special in building up relationships, and doubtlessly the most successful within the saint borders of the Country of Freedom – comparing to population – are in debt to the respect and the deeper knowledge of the infinitely brilliant history of the human freedom and rights.

In 1492, the Genovese explorer Christopher Columbus, contracted by the Spanish crown, reached on some of the Caribbean Isles, marking the first contact with the native people.

sions on taxes Britain collected, even though American colonies weren't represented in the Kingdom, the abrogation of every law the British didn't like, failings to agreements, send the Congress to the decision on preparing the Independence Document. Thomas Jefferson was the chairman of the elected Committee for this document. While the Committee members were working, the Congress continued on arguing about the question of independence.

The historical day of July 4th 1776 came, when the Independence Statement

the name of global freedom and democracy, America gives a physical image of Jesus Christ. Its has surface of 9.83 millions of kilometers square, and a population of 308.745.538 inhabitants, according to the census of the 2010 year's 1st April, known as the official census day. The registration forms were prepared in 59 various languages.

According to the last study, 78,4% of the adults were identified as Christians, while the total of non-Christian religions was reported 4,7%. Religion therefore makes a very important point, as the

ing natives from their land east to Mississippi and destroying their habitats on west Arkansas and Missouri. The native had their habitation in these lands, which now are considered as Indian wildlife-sanctuary. America is now holding the primary role in global developments, especially after September 11 of 2001, when terrorists of Al-Qaeda hit the World Trade Center in New York and the Pentagon in Washington D.C., killing almost three thousand people, citizens of the world, American citizens, and Albanians too were among them.



This 4th of July, the Country of Freedom and democracy will feast the 235th anniversary of independence. It was right the 4th of July 1776 the blessed day when the Continental Congress voted on approving the independence document, marking it as the official Independence Day of the USA. That blessed day came after Britain could divide the American colonizers, while three Americans on four were completely faithful to Britain. People, therefore, couldn't imagine getting something through war. America had human capacities; it had an elite as well as freedom heroes.

After the open revolts and fighting between colonies and British military troupes, the delegates of the 13 America's colonies gathered in Philadelphia in the Continental Congress meeting. Discus-

was voted. It accused the British Government for all injustice made to colonies. It stated that governments exist only to defend their people's rights. It also stated that people had the right to change its government, if this was denying them their rights. This fundamental document of human rights and freedom was never revised. In 1783, the Great Britain acknowledged their independence and gave them the lands behind them up to Mississippi River. Due to the federal Constitution made on September 17, 1787, George Washington was proclaimed President of the United States of America in 1789.

Thus, Americans, though new in their land, with a history that was more than tough to them, are the most tolerant and right, as well as the most powerful country in the world. Like a Lord sacrificed in

American Constitution states: "In God we trust".

America of Freedom which opened the doors and the hart to all the races has done the 23rd census, for the American Constitution has stated a census once every 10 years. The first census in America was in 1790.

The US economy is the biggest in the world, with an estimated GDP on over 14.3 trillion of dollars, in 2008, (almost 23% of the nominal world's GDP and almost 21% according to the population capacities). The foreign policy is the main weapon of the super-country. The immigration caused a huge development of the American economy. Migration and immigration, increasing population and bringing in the most illustrious minds of the world, had its influence on mov-

The democrat Barack Obama, the 44th American President, the first Afro-American holding this position, is the best example of materialization of rights and freedom God gives people on earth. All the previous presidents were originated from Europe.

No doubt, the Albanian people, with a glorious past originated in Illyria, as one of Europe's most ancient people, has found its strong sustain in America. The Albanians see the today's American Ambassador in Tirana, Alexander Arvizu, as defender of the most elementary rights. America loves us very much, but we have to love ourselves first.

**Sokol Pepushaj**

# Kole Laka Durgaj patriot ne mes patrioteve

## U VRA NGA FORCAT PARTIZANE NE JANAR TE VITIT 1945

Tregim historik nga  
**Gjeto Turmalaj**  
Poet e shkrimtare  
New-York.



Në Shkrelin piktoresk, aty mes maleve epike, ku zanat shëtisin vargmalit të Kurrisles dhe mbarojnë lodrimin tek mali i Pultinzes me pyje e lëndina, pikërisht në atë luginë epiko-historike, ndodhet mëhalla Bzhet-Makaj e Ducajt. Këtu ishte njëri nga vendbanimet e kahmoteshme në të cilin rreth fillim-shekullit 20-të numroreshin rreth 15 shtëpi që jetonin në harmoni të perbashket. E sigurisht ndaj edhe në krye të vendit e atë mehallë të Ducajve udhëhoqej nga fisi i mirenjohuri i Dedë Gjeka Ivanit që më vonë mori mbiemrin që kanë edhe sot Durgaj, i cili për nga rëndësia që kishte Dede Gjeke Ivani, pikërisht të kisha e Shkrelit pati edhe gurin ku i takonte të ulti, si i pari i fisit që ishte ky kreshnik i njohur në tane Malësinë e Madhe. E saktësisht nga kjo vijimsi brezash vijoje perjudha me trashëgimtar të njëpasnjëshëm, kur me vonë vjen ndër tjerë edhe Kole Leka që ishte i shkolluëm në Itali. Duhet të cilësojmë se në ato vite të largëta kishte mjaft pak njerzve që paten mundësi të studjojnë në vende të huaja. Këtë fat e pati Kol Leka (Durgaj), të studjojë në Itali për pyjet.

Kola ishte njëri i mirenjohur në Shkrel, Malësi të Madhe dhe në Shkodër. Kudo i merrej mendimi Kolës, se bashku me burrat e tjerë të atij trulli për ato probleme të ndryshme që nxirrte jeta, fatëkeqesive natyrore, tuj u ardhë në ndihmë me sa kishin mundësi hallexhijvet, jetimëve, pleqëve, apo ndër morte e dasma.

Po cili ishte Kol Leka? Ai lindi në pranverën e vitit 1918 në luginën e bukur të Shkrelit në Ducaj. I ati ishte Lekë Gjeka, nipi i Dedë Gjeka Ivanit, një burrë i urtë e i mirenjohur në Shkrel e më gjerë. Ndersa nana e tij ishte Prena e Gjokë Tahirit, bije prej Selcës, një malësore burrneshë e sojnikë, sikurse janë bijat e Kelmendit.

Kola qysh në rininë e hershme e pati lënë vendlindjen, Ducajt e Shkrelit dhe ju drejtua udhës së bukur por të vështirë të djetës për jetë, për të shtuar aftësimin e për tu shkolluar, që në fillim u vendos në konviktin e "Maleve tona" në Shkodër, ku mori mësimet e para në kolegjin "Saverjan" dhe pastaj, si një nxënësi mjaft i zgjuar që premontonte shumë, u dergua nga Kolegji i Shkolles për studime të larta në Romë, Itali, ku mbaroj shkollën Feristale që në ditët tona quhet Shkolle Pyjore. Duhet përmendë se Kola mbas mbarimit studi- meve në Rome e kthimin në vendlindje, zhvilloj e ushtroj me aftësinë e veta Teleferikun e parë në Malsi të Madhe. Aty dha një ndihmë të madhe ekonomike për kohen me përfitime e punësime, gjë që pati edhe një zhvillim në mardhënie tregtare të asaj periulle me ane të lëndve drusore që i dërgonin prej Shkodres në Itali. Pra në ato vite ishte një periulle e arte për Kolën, e cila bëri që ai të njihej e të miqësohej me disa tregtarë të Shkodres. Kola ishte një person me impozancë të lindur, ishte trim me armikun, por edhe i butë me mikun, e mjaft

i zgjuar. Vitet e luftës 1940 që pasuan njëri tjetritin në rrjedhat e historisë, erdhen me ato periudha shumë të vështira e të përgjakshme për kombin shqiptarë për Malsinë e Madhe në veçanti janari i vitit 1945 trokiti i ftohet, mjaft me acar. Në atë periudhë po bëhej një mbledhje e fshhtë në luginën e Rjodhit nga udhëqësiti partizanë të asaj kohe me në krye Rexhep Valbona. Ata i thirrën ato parti siç ishin "Balli Kombtar", "Legaliteti," me qëllim për t'i dale "zot" vendit nga sulmet e pushtuesve nazi-fashistë. Në atë tubim njëri nga pjesmarrsit ishte edhe Kolë Leka si përfaqësuesi i mehallës së Ducajve se bashku me bij të tjerë të krahinës Shkrelit. Në mbarim të mbledhjes që u zhvillua me mjaft debate, me një gjakanxhtësi të ndërsjellë nga pjesmarrsit e malësise, të dy palët nuk u dakortësuan në asnjë mënyrë me pikpamjet e njëri tjetrit. Sigurisht me komunistet u ndan jo si miq, por si armiq. Në mes tyre ishte ky precedent që po mbjellte fara e komunizmit gjakatar nëpër atdhe. Duhet thënë se përfundimi i mbledhjes pati edhe kontradikta të papajtueshme sikurse u tha nga vete komunistët. Madje nga ata

mjaft e rëndë e madje e paturpshme, për ata komunistë të struktur që drejtuan pushkën nëpër dritën e hënës, duke gjuajt direkt në grumbull të pasagjerëve te makinës, gjë që per ata shkreljanë ishte një ngjarje e papritur pas krismës së revolverit. Situata solli një gjë krejt të pabesuar. Makina u ngut të eci me shpejtesi për t'iu larguar asaj "prite" që kursesi nuk mund të imagjinohej në ato rrethana që ata komuniste të pa cipë e kriminelë, te drejtojnë pushkët për të marrë jetën e vëllezërve të vet. Shqiptari po vriste shqiptarin, malësori po vriste malësorin.

Rruga e makinës drejt Shkrelit nuk zgjati shumë mbasi pa u afërua te vendi i njohur si "Pusi i Çokajve" u konstatua se Kolë Leka u rrëzua në mes njerzve të larë në gjak. Kolën e kishin marrë ata plumba që u qëllua nga dora e kriminelëve partizanë. Në atë situatë fatkeqë që u krijua, shoferi guximtar Nik Toplana e kthej makinën për ta dërgua Kolën në qytezën e Koplikut për ti ardhë në ndihmë Kolës që ishte në agoninë e fundit të dhënjes shpirtit, pa i pas askurkujt gjakë as borxhe. Në Koplik ndodheshin dy doktora italyan, të cilët

Mul Delija. Mbasi i thirri britmen malësorja e vajtorja me zë në Shkrel, mbesa e Gjelosh Gjokës së Bajzës Kastrati, Lene Preça, atë moment Mul Delija nxorri nga xhepi dy napolona florime i'a falë brimtares (vajtojces) që e qau me fjalë të dhimbshme Kol Lekën në vig. kundërshtimi i fisit konsistonte se vajtoja nuk paguhet, atëhere Mul Bajraktari tha:

-Po more burra, kjo brimtare e qau kaqe trishtueshëm madhështinë e këtij burri vigan që humbi jetën e po e varros sot malsia e unë po ju them se ndoshta sikur po vepron komunizmi dhe nder neve, ndoshta mbas një jave ka me na ardhë rradhë ne me na leshua gjamen kjo brimtare, e pra e le ta blejë një rubë të zezë për me kja trimat e malsisë tonë kreshnike.

Këtu po sjedhim disa nga vargjet e atij vajtimi nga Lene Preça...

Po te vajtoj me trishtim...

O vigan Kolë Leka

Pikë sokoli te paska marrë vdekja.

Prej kësaj kulle po del gjama.

Për dhe të zi sot të çon nana.

Po të kjane Shkreli, heu medet

O Kolë po të kjane djali yte në djep



udhëqësiti komunistë, ku shpalesh edhe kercenime me urdhra, me tone aq të larta e të forta që u ndane në mes tyre duke thene:

"Që tani e mbrapa juve jeni kundërshtarët tone më të egër dhe prandaj si malësor të pabindur duhet të ruheni nga neve si partizan.

Dhe malsorët duhet të ruheshin shumë se komunistat ishin të pabese. Pikërisht atë mbsadite kur malsoret e Shkrelit duke udhëtuar për në vendbanim e tyre me një automjet ku ishin të shtërnguar njëri me tjetritin në karrocërë e maqinës, ishte buzmemëramje koha, kur maqina që derjtohej nga shoferi Nik Toplana, sapo kaluan neper Koplik për të dalë në Koplikun e Sipër, ty mbi Hanin e Dul Nutit, ndoshta diku gadi 200 hapa me pranë vorrezave te vjetra, ndodhi një ngjarje e papritur dhe e paprecedent. Ishte momenti kur një këngëtar në karroceri të makinës së Nik Toplanës përfundoi këngën malësore epike që quhet "maje krahut", ku edhe u përhendet jehona e saj me dy krisma revolveri, për kënaqsim që ju dha të pranishmëve ajo këngë në atë karroceri makine. Hëna e argjendte porsa kishte dalë mbi Maranaj. Pranë rrugës, në një përrua, malësorëve të Shkrelit ju kishin zënë pritet një bandë me komuniste dhe simpatizantë të cilët kishin marrë urdhra të qarta nga komanda. Fatkeqësisht ndodhi ajo që nuk duhej të ndodhte,

me shpejtësi e vizituan, por nuk dhanë asnjë shpresë për jetën. Ata folën në mes tyre se i plagosuri për vdekje i ka minuat e numëruara. Mjekët nuk e dinin se Kola kishte studiuar në Itali dhe dinte gjuhën e tyre dhe në ato sekonda agonie reagoi, u përmend e tha: "O Fran Pjetri je derë e shkollueme je kushrini i Llesh Marashit... merri o Fran dokumentat e mijja në xhep e jepja nanës Prene në Ducaj... Oh vllaznit e mijë, ju baj të gjithëve...! ire e hallall." Në ato sekonda Kola mbylli sytë me lot neper faqe e gjak nëpër gojë. Edhe në mesin e njerzve tjerë në makinë u konstatua se i mirenjohuri Tom Nika i Dedajve kishte marrë plagë të rëndë në krah, duke i kaluar plumbi nëpër kockë të krahut dhe për pasojë më vonë u konstatua se i ishte thyer krah... Eh, Tom Nika shumë i respektuar, një burrë i qetë, një patriot mjaft i urtë e i shkolluar, kishe kaluar vite të shumta në mergim në Mal të Zi, si kundërshtar i Mbretit Zog i I-re. Tomën e dënoj fati edhe të plagoset nga rregjimi gjakatar komunist, atë plagë që mbajti deri në fund të jetës.

Në Ducaj të Shkrelit u bë një ceremoni e përmortëshme në ditën e varimit të Kole Lekës, këtij biri të denjë të Ducajve. Kishte ardhë Shkreli mbarë, shtëpi për shtëpi dhe miq e shokë nga trevat e Malsisë. Kudo dëgjoheshin britma, gjëmë dhe vaje. Kishte ardhë edhe Kryebajraktari i Malsisë së Madhe

Po derdh lot mbarë malsia. Me të kja ka ardhë dhe Mul Delia. Partizanët të vranë në pritet Në Koplik, e ju plaçin sytë Komunistat këshu janë tuj bu Me fut në luft vëllaun me vëlla. Asht tu djetegë kullat në flakë Asht tuj vra njerzit pa hak Asht tu e la malsinë në gjak He vrafti rrufeja në çdo konak.

Intelektuali Kolë Leka, trimi i Shkrelit, nuk e pati fatin të gëzonte shumë kohë martesën, madje nuk i kish mbushë 2 vjet, por vetem disa dite para se të vdiste, ndoshta 15 dite me parë, Kola ishte gëzuar jashtë maset me lindjen e djalit që ia fali Zoti për të trashëguar atë shtëpi. Por fatkeqësia e madhe ishte se Kola duke pësuar atë vdekje tragjike e la bashkeshorten te veje. Në të vërtetë sikurse lexohet në ketë shkrim modest asht në nder të kujto që të thuhet që Malsia ka rritë mjaft bija trime e kurrajoze me virtyte të mëdha njerzore që nuk mbrapsen as nga pesha e randë e fatkeqësive që ju sjellë jeta. E një prej këtyre bijave sojnikë ishte edhe bashkëshortja e Kolë Lek Durgaj, Drande Dodë Gjelosh Narkaj (Durgaj) prej derës së njohur të Gjon Mirash Dedës së Jugomirit në Bratosh, që quhet Katundi i Kastrati, ku ka rranjet e vjetra fisnore krejt Kastrati. Jo rastësisht edhe Mark Gjeloshi, axha i Drandes njihet si

njeri prej luftëtarve me guxim heroik në perballje shpatë për shpatë me turq në kala të Moksetit. Marku në atë betejë të përgjakshme mbasi preu me shpaten e tij 3 turq pushtues, por nuk e kishte vërejtë tinzllëkun e një ushtari turk kur i doli nga mbrapa shpine në llogore e i'a preu kryet Mark Gjeloshit, dha shpirt në fushë të betejës.

Drande Dodja e tregoj vërtet vehten e saj një fisnike, burrnesh, me karakter stoik, tue qenë edhe nipe e Fran Market Traboinit, shtëpi heroike e trevës Hotit. Drandes i kishte fale Zoti edhe nje pamje mjaft sokoleshë, me nje temperament të pa thyeshem. Ajo e tregoi me vepra tërë jeten e saj, e cila mbasi i vdiq bashkëshorti i saj nderuar Kolë Leka nga dora e zezë e komunistave në pritet, ajo si nje Nore e dytë vendosi të mos i nxjerrë kurrë fat vehtes, por qendroi burrërisht dhe e rriti, mesoj e edukoj birin e vet te shtrejtin e jetes Luigjin. Është per t'u akcentuar se nga ngjashmëria, hijeshia, burrnia, fisnikria e guximi, Luigji është vërtet një kopje e trashëgimit plotsisht te babes së vet....

Kur e analizon këtë ngjarje, detyrimit që të lindin nje revolte e brendshme shpirtore, kur e mendon dhe e gjyon për sa u tha me lart, dhe e vërtetuar ashtu sikurse është pohuar nga dëshmitaret e kohës se: -Kolë Leka ishte pjesmarrës në mbledhje si kundërshtar i inicimit komunist që po kërkonin me ngulm e posaçërisht duke mos njohë te drejtat e ligjeshme të patriotëve Shkrelas e mbarë malsisë, pra i tillë i papajtueshëm mbeti Kola deri në vdekje. Kola ishte intelektual që kishte mbaruar studimet jashtë shtetit dhe komunistat nuk e donin.

Ndoshta ndonjë skeptik duke lexuar ketë shkrim me atë meskinitetin e tij mendon që Kola u vra në grumbull të njerzve, e nuk e vrau kush për emrin e tij si intelektual apo i atyre partive pjesmarrese, sigurisht që nuk e njohu kush naten për hënë në mes njerzve. Dhe krejt natyrshëm vjen edhe pergjigja: -Po në fronte të luftës ku zhvillohen betejat në grumbull të njerzve, pikërisht aty drejtohet pushka dhe atëher i merr jetën kë të zërë plumbi i pushkës, sepse janë në front perballë njëri tjetrit kundërshtar, detyrimisht për pasojë edhe Kolë Leka ishte kundërshtar i rreptë, që në mbledhje të drejtuar nga R. Valbona, pra aty e mbrapa ishte armik i pa pajtueshem i komunizmit bashkë me ata shkrelas të tjerë, por fatkeqesisht Kolen e kapën ato plumba që i dheruan vdekjen në moshën më të bukur te jetës, duke lan nënen e vet pa djalë, duke lënë djalin e tij jetim që në djepë dhe bashkëshorten e shtrejtë të ve.

Prandaj është e domosdoshme te thuhet me zë të lartë se:

- Kol Leka është një nga Martirët e Shkrelit. Madje edhe i ashtuquajtur komisoni që vendosi Plakatën në Lapidarin e Dedajvet, ne perkujtim te martirve Shkrelas, duhet te kishite vendos edhe perjetsimin e emrit Kolë Lekë Durgaj, por ashtu siç jan lënë edhe disa figura të tjera per tu nderuar, në këtë plakatë është lënë në harresë edhe Kole Leka e sigurisht që ky intelektual i Shkrelit do mbetet në panteonin e historisë, në memorijen e popullit, në shkrime e në histori si dëshmor i Atdheut dhe Krenaria e Malsisë Madhe

Materiali i marre për bazë:

1.Marash Mali Shkrimtar, historian, në moshen mbi 90 vjeç si bashkëkohes i Koles,

me banim në Florida. USA.(Materiali komunikim gojor)

2.Fran Gjeto Xhajaj ka botua nje liber, sot mbi 80 vjeç, si bashkëshkrelas, me banim në Michigan. USA. (Materiali, komunikim gojor)

3.Luigi Kol Durgaj, i biri i Kole Lekës me banim te përkohshem në New York. USA. (Me komunikim gojor).

# Në Kelmënd ku magjia prishet...

Nga **Rush Dragu**

Rapshe e Hotit. Te ngjan se e le jeten reale dhe u fute në magji. Eshte ajri i paster qe te ben te dyshosh mos nuk ie mire me veshet. Por ecen pak kilometra dhe e sheh veten ne Kelmend.

Këtu magjia prishet. Është vetë një magji ky vënd. Një amfiteater natyror rrethuar me male të veshura me pyje, gjelberim, borë e qiell. Po po, edhe te veshura me qiell se e kanë kryet lart. Po, këtu edhe po punohet. Ka më shumë se dy vjet që është duke u punuar në segmentin rrugor Han i Hotit –Tamare, e gjatë 28 km. Gjysmes prej 14 km nga Hani i Hotit në Rapshe i është hedhur shtresa e parë e asfaltit dhe më parametra prej dy kalimesh dhe hapsira ndërrimi për të dy drejtimet. Të përfunduara të gjitha veprat e artit, përfshirë dhe ujembledhsit, transportuesit dhe shkarkuesit. Gjysma tjetër po vazhdon...

## HISTORI TË NDRYSHME NDERTIMI DHE RIKONSTRUKSIONESH TË HERËPASHERSHME

Segmenti Han i Hotit Brigje 6 km ka filluar të ndertohetë kohen e zhMbretërisë Shqiptare rreth viteve 1929 dhe është përfunduar nga Italia Fashiste në vitin 1939. Kjo rrugë ka qënë njëkalimshe dhe e shtuar me kalldëm të lehtë. Nga Gryka e Kushes deri në Brigje ishin Leqet e shkurtra të Brigjes të cilat nga gojdhënat e kohes janë bërë sipas preferencës së inxhinjerit Italian për të shkuar afer shtëpise së njerit nga miqt e tij në atë lagje. Kjo rrugë mbetet në atë gjëndje deri nga gjysma e vitit 1966 kur qeverija e asaj kohe vazhdoi ndertimin e rruges së metejshme në drejtim të Kelmëndit duke ndjekur këtë vije geografike

ndertimi, Brigje-Stare-Rrapshe Hotit-Leqe Hotit- Grabom –Tamare. Kjo rrugë ndertohet nga studentet e Univeristetit të Tiranës dhe nga forca të Ushtrisë Shqiptare të kohes e gjitha me punë vullnetare dhe totalisht me punë krahu. Ndertimi i ketij segmenti përfundoj në më pak se dy vitë duke u germuar dhe hapë më qindar meter kub gurë dhe dhe.

Pastaj në vitin 1967 do të vazhdoj ndertimi i segmentit (Lotit të dyte) nga Tamara në Qafë Predelecit e gjatë 20 km e gjitha e ndertuar po me punë vullnetare siç quhej për kohen nga student të Univeristetit të Tiranës dhe forca të shumta të Ushtrisë Shqiptare. Ky lot ka mbaruar në fillim të vjeshtes së 1967-es. Ky segment ka ndjeke luguinen e Cemit të Selces (Cemi i Kelmëndit ka dy deqe që sipas vëndosjes marrin dhe emrin, Cemi i Vuklit dhe Cemi i Selces të cilat bashkohen tek Ura e Tamares) Ky Lot në shumicen e rasteve nuk i ka qëndruar intinerarit të rruges se vjeter (për këmbësor dhe karvane kuajsh) që ka pershkuar luginën dhe lidhe pastaj më tutje me Guci ,Plave,Peje e Gjakove.

Per arsye të kushteve të dimrit nderpriten punimet e segmentit Qafë Predelecit Vermosh dhe rifillojnë në pranveren e 1968 e cila përfundon shumë shpejtë per arsye të kushteve të pershtatëshme për të perparuar. Duhet nënvizuar se segmenti Gropat e Selces – Qafë Predelec- Budaç – Bashkim Vermosh është shtruar e gjitha me çakëll të kuq marrë nga Gropat e Selces (më sakte në Fundshkallë)

Me kalimin e viteve do të hapen kapilare rrugore nga Qafa e Predelecit në drejtim të Jeshnices dhe nga Vermoshi në drejtim të Skrabotushes e Maje të Viles e kthyer në kilometra do të ishte më shumë se Vermosh Konispol e cila i ka shërbyer qeverise se kohes për shfrytëzimin e pyjeve të Kelmëndit,shkullor për

nga historia dhe me vlera kolosale të kthyer në dollar për nga vlera.

Në vitin 1976 (më saktë në vjeshtë të atij viti) segmenti rrugor Han i Hotit –Rapshe është asfaltuar duke i qëndruar besnik aksit rrugor ekzistues.

Në atë gjëndje do të qëndroj deri në vitin 2001 kur Qeverija Berisha nga Fondi i Zhvillimit Shqiptar do të marrin hapin për rikonstruksionin e plote të Rruges së Kelmëndit me parametra bashkëkohor dhe modern.

Fillimisht Loti, Han Hotit –Rapshe kishte si ide që të devijonte trasenë tradicionale të vjeter, duke marre shpatin në drejtim të Kastarit, gjë e cila ishte një si një thikë me dy presa për banoret e Hotit, Brigjes dhe ndryshe për kelmëndasit. Të paret do të ngeleshin jashtë vëmëndjes dhe trafikut rrugor e të dytet (kelmëndasve do tu shkurttohej rruga dhe do te ulej përqindja e pjerrise). Përfundimisht do të fitonte variant i trasës së vjeter asaj ekzistuese.

Në këtë segment ka nderhyrje të fuqishme në germim dhe mbushje duke eliminuar pjerrsinë dhe një leqe në Brigje. Gjatë gjithë segmentit ka mure që kanë shërbyer për mbushje dhe mure mbrojtëse që do të mbrojnë shembjet dhe erozionin dhe shëmbjet. Në këtë segment është ndertuar e re një ure e re në kthesen e Fund Stares dhe shtrim dhe zgjerim në fshatin Brigje. Po ashtu ka një gjysem tunel tëk shpella e Stares. Përgjithesisht germimet dhe mbushjet kanë bërë që të zbutet pjerrrsia dhe në të shumten e segmentit nuk e kalon 3 – 4 % që lejon shpejtesi 45-50 km/h e më shumë. Ketij segmenti rrugor i është hedhur shtresa e parë e asfaltin. Është dy kalimshe dhe më mundesi parkimi në shpatullat rrugore.

Segmenti dytë, Rapshe (ish Kloni i kohës së diktatures) deri në

Tamare është në perfundim e siper. Parametrat janë të njëjtë me segmentin e pare Han Hotit- Rapshe por shkalla e vështërsise ka qënë dhe është më e madhe. Nga Kloni deri tek Ballkoni ( aty kun ë vitin 1967 ,Enver Hoxha vrejti nga larg Kelmëndin) ka dy çarje të maleve respektiv,fillimisht tek Kloni dhe pastaj tek Ballkoni duke krijuar hapsirën e domosdoshme dhe duke ruajt pjerrrsine afer 0%. Rruga ka kompanise së ndertimit i ka kushtuar shumë në kohe dhe në volum janë Leqet e Hotit,pasi i gjithë materjali ,gure e dhe është transmetuar nga Leqja e fundit deri tek e sipërmyja në Rapshe tek Grop e ish Klonit të Vjeter.Guret janë grirë për tu perdore për beton (kjo metodë është zbatuar gjatë gjithë aksit nga kompania) në stacionin e betonit, ngritur në Rapshe. Ky veprim është bërë me qellim ruajtjen e terrenit (bimësinë dhe drure e shkurre) e ,mos mbushjen e Luginës së Cemit.

Gjatësia e ketij segmenti (Klon – Qafë Kryqë),pra e Leqeve të Hotit është 4.4 km.

Ndërsa në segmentin ( i cili është pjesa që është punuar dhe më pak) Qafë Kryqë deri tek Uji i Grabomit i gjatë 1.6 km është duke u punuar në germim dhe sa kanë filluar veprast e artit. Në kthesen e Grabomit ( pa arritë tek Uji i Grabomit) ka ndertim të një Ure të re dhe me dy kalime.

Nga Uji i Grabomit deri në Tamare i gjatë 8 km janë përfunduar pothuajse të gjitha veprat e artit,muret mbushse dhe ato kunder grryrje shembjeve,tombinat dhe ujembledhsit dhe ujeshkarkuesit.

## URA E TAMARES

Në vitin 1967 mbi varjantin Turk është kryer mbushje duke ruajtur të paprekur strukturën e moçme me vetem mbushje me beton, pjesa e kurrizit të ures. Por Kelmendi plot

histori ruan si relike çdo vlerë

Në varjantin e ri të rruges,ura e vjeter do te mbessë, me synimin për restaurim të varjantit të vjeter Turk dhe do të ndertohet urë e re dykalimshe në drejtim nga perendimi.


Po ashtu me varjantin e ri është shmangur aksi rrugor që ka kaluar nga Qendra e Tamares duke kaluar në luginën lindor pas objekteve tregtare të Tamares. Është përfunduar Pedonalja e Tamares me projekt modern.

Po ashtu para pak kohesh është kaluar tenderi i ndertimit të Lotit të Trete Tamare Jasanovë në drejtim të Vermoshit.

Duhet theksuar se edhe qeveria Malazeze ka një kontribut financiar për ndertimin e Segmentit Tame – Vermosh pasi banoret e qyteteve Guci,Plave e më shume u krijohet mundësia e udhëtimit më të shkurter dhe më komod në drejtim të Ulqinit,Podgorices dhe Shkodres. Rruga ekzistuese e tyre rreth 270 km për në drejtim të Podgorices do tu shkurtohet në 55 km dhe 70 % e saj pothuajse gjatë gjithë vitit nuk mbulohet nga reshje te debore. Vetem segmenti Gropa Selce – Gerçarë,Vermosh rreth 10 km ka reshje debore.

Drejtuesit e kompanise ndertuese të segmentit Hot-Tamare shpresojne që ta kenë të shtruar asfaltin në vjeshten e dytë të ketij viti.

*Legjenda e segmentit rrugor Han Hotit-Tamare 28 km  
Rotondo e Hani Hotit- Tek rruga për Kastarat- 11 km  
Rotondo e H.Hotit- Tek ish Kloni – 14.5 km  
Fusha e Rapshe = 2 km  
Nga Kloni – Qafë Kryeq (Leqet e Hotit) 4.4 km  
Nga Kloni – Uje i Grabomit 6 km  
Nga Kloni – Qëndër Tamare = 14 km*



Zgjidh mënyrën më të mirë për t'u informuar  
WWW.HERMESNEWS.ORG

**HermesNews.org**